

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7803 E hënë 25 Shkurt 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Dje  
**në** Radio Evropa e Lirë

Arritja e një marrëveshjeje paqësore ndërmjet Kosovës dhe Serbisë gjatë vitit 2019, nga presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, është konsideruar ...  
Vijon në faqen 20

Nga ARTON KONUSHEVCI

Marrëveshja Kosovë-Serbi, në funksion të stabilitetit në rajon



Opinion  
**i** Ditës

Disave nga më alarmentët prej nesh po na duket se viti i mbrapshtë 1997, me pasigurinë e tejskajshme për jetën, me 3 mijë të vrarët dhe me një gjendje ...  
Vijon në faqen 21

Nga FATOS ÇOÇOLI

Po troket përsëri '97-a?



Kuvendi s' bën shpalljen e vakancave për 56 deputetët e dorëhequr

## Djegia e mandateve, variantet që po diskuton PS për të dalë nga kriza

Mediu kthehet nga Vjena, firmos ikjen. Rama: Opozita ka frikë të përballit në zgjedhje. Berisha: Fundi do të vijë nga ata që s'i quan popull

Kreu i qeverisë, Edi Rama, vijon të mos e njohë protestën e opozitës si produkt i një pakënaqësie popullore ndaj qeverisjes së tij, por si rezistencë ndaj reformës në drejtësi dhe në mënyrë të veçantë për të anatemuar zgjedhjet e ardhshme vendore, të cilat sipas tij, ajo nuk i fiton dot. Në një intervistë për gazetën italiane "Il Fatto Quotidiano", kryeministri Edi Rama ...

Në faqet 2-3

## VENDIMI I RI I QEVERISE: KUSH DO TE PERFITOJE NGA TRAJTIMET E VEÇANTA

# LIGJI, SA DO TE RRITE PENSIONET E USHTARAKEVE

ISSH sjell shembujt konkretë: Kujdes, cila është formula e saktë e përlllogaritjes! Zbardhen 8 kategoritë që do të marrin më shumë para



(Në foto) Ushtarakë (foto ilustruese)

Në faqen 7

### SITUATA POLITIKE

Ministrat e deputetët socialistë marrin urdhër: Jo më debate me opozitën

Në faqen 5

### NGJARJA NE DURRES

Vritet pas sherrit në lokal me fqinjin Martin Ndreca, në kërkim Ndue Zefi

Në faqen 6

### UDHEZIMET

Lotaria amerikane, ambasada: Fituesit e 2019-ës të kontrollojnë 'email'-in

Në faqen 9

### MERJA: SI TE SHMANGNI ALERGJITE

Mjekja Vlera Lekaj: Yndyrat në gjak dhe rreziku që sjellin për zemrën

Në faqet 4-5

Suplement

### VENDIMI I FINANCAVE



Ish-të përndjekurit, 5 mijë trashëgimtarët që marrin paratë, listat e reja

Në faqet 10-12

Kryetarja e PS-së së Tiranës: Shqiptarët nuk e meritojnë këtë opozitë

## Gjylameti: Do vazhdojmë jetën politike, dialog brenda rregullave

"Veliat kandidat? Do e përcaktojë analiza e strukturave"

Kryetarja e Partisë Socialiste për kryeqytetin, deputetja Blerina Gjylameti në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", tek analizon situatën politike të krijuar pas protestës së opozitës dhe lënies prej saj të mandateve të deputetëve, ashtu si kryeministri Rama, shkaqet i



INTERVISTA

lidh me reformën në drejtësi dhe sondazhet parazgjedhore të mbështetjes që gëzon në popull. Sipas saj, shqiptarët nuk e meritojnë kurrë një opozitë të tillë, që prish kontratën me popullin për të shtruar në tavolinë kontratën për ...

Në faqet 4-5

## KRIZA POLITIKE MAZHORANCA

### Berisha, Ramës: Fundi do të të vijë nga ata që nuk i quan popull

Ish-kryeministri Sali Berisha ka reaguar ashpër ndaj intervistës që kreu i qeverisë, Edi Rama, dha një ditë më parë për mediat italiane, ku edhe thekson se protestat e opozitës nuk ishin popullore, por partiake. Sipas Berishës, ky është tipar dallues i çdo diktatori që nuk dëshiron të shikojë dhe të pranojë reagimin popullor: "Kur verbohesh sytë e mendjes, personi humbet çdo komunikim me realitetin dhe ka marrë fund. Kjo sindromë i çdo diktatori e ka pushtuar Edvinin. Ai dje iu tha mediave italiane se protesta e studentëve ishte pro-



testë, sepse studentët ishin popull. Kurse protesta e cunamit e popullit opozitar nuk ishte, pasi sipas tij, ata nuk janë popull. Pra, sipas tij, nuk janë popull ata qindra mijëra qytetarë që mbushën rrugët dhe

sheshet e Tiranës si kurrë më parë më datë 16 dhe 21 shkurt. Jo, ata nuk janë popull, pasi për atë, ata janë të padukshëm. Edvin, vërtetë tmerri të ka verbuar sytë e mendjes dhe nuk të lejon t'i shohësh

ata, paçka se ata të padukshmit të detyruan t'ia mbathësh për në Vlorë dhe të rrethosh parlamentin me tela me gjemba si kurrë më parë", shkroi Berisha. Më tej, ai thekson se fundi i Ramës do të vijë pikërisht nga revolta e qytetarëve, që është ndezur në të gjithë vendin. "Ky është verbimi i syve të mendjes, verbëria absolute, sindromi më i tmerrshëm i çdo diktatori që shfaqet tek ai para se t'i vijë ngordhja nga të padukshmit, nga ata që ai nuk i quan popull. Mjerë ti, fati i zi i tyre të pret. Lipsu, lipsu një minutë e më parë!", shkruan më tej Berisha.



Kryeministri shprehet se Shqipëria s'është në kaos dhe protestat s'janë popullore

## Djegia e mandateve, Rama: Opozita ka frikë të përballet në zgjedhje

"E kanë bërë të gjithën për të bllokuar reformën"

Kreu i qeverisë, Edi Rama, vijon të mos e njohë protestën e opozitës si produkt i një pakënaqësie popullore ndaj qeverisjes së tij, por si rezistencë ndaj reformës në drejtësi dhe në mënyrë të veçantë për të anatemuar zgjedhjet e ardhshme vendore, të cilat sipas tij, ajo nuk i fiton dot. Në një intervistë për gazetën italiane "Il Fatto Quotidiano", kryeministri Edi Rama thekson se protesta dhe djegia e mandateve e kanë burimin pikërisht tek këta dy faktorë, pra krijimin e institucioneve të reja të drejtësisë dhe frikën nga humbja në zgjedhjet e ardhshme vendore.

### Z. Rama, çfarë po ndodh në Shqipëri?

Nuk ka asnjë lloj kaosi apo revolte nga populli. Në shesh nuk janë as "jelekët e verdhë", as sindikatat, as studentët apo grupe anarkistësh, por opozita parlamentare, që pak vite më parë u dërgua në shtëpi nga populli, pasi e mbyntën vendin në korrupsion dhe pandëshkueshmëri. Nuk mjaftoi me



kaq, pasi vitin e kaluar morën një goditje edhe më të fortë në zgjedhje. Dhe tani nuk duan të përballet në zgjedhjet lokale, sepse e dinë që i pret një humbje tjetër. **Cili është qëndrimi juaj dhe i qeverisë suaj lidhur me vendimin e minorancës për të lënë mandatet par-**

### lamentare?

E kanë bërë të gjithë për të bllokuar reformën në drejtësi, që nisëm së bashku me BE dhe SHBA, por që nuk kanë për të na ndaluar dot. Tashmë është në rrugë një revolucion i vërtetë kundër sistemit të vjetër e të korruptuar të drejtësisë, nën

mbikëqyrjen e miqve evropianë e amerikanë. Do të kemi një prokurori speciale të antikorrupsionit të funksionarëve të lartë, në bazë të ligjit të reformës së miratuar. Më shumë se 50 gjyqtarë e magistratë të lidhur me afëra e të korruptuar, falë vetingut janë nxjerrë jashtë radhëve të sistemit e shumë të tjerë janë në radhë për t'u nënshtruar. Të gjithë nën sytë e një skuadre ekspertësh ndërkombëtarë. Si të mos ketë lëvizje të forta nga pjesë të pushtetit të vjetër kundër kësaj qeverie?!

### Pse opozita ju akuzon për korrupsion?

Çfarë mund të bëjnë tjetër përballë vështirësisë në të cilën ndodhen? Njerëzit nuk i ndjekin dhe frika e drejtësisë i persekutojnë. **Si është e mundur që shumë kryebashkiakë të Partisë Socialiste, partisë suaj, janë pasur probleme me drejtësinë?**

Kjo nuk është e vërtetë. Në qeverisim gati tre të katërtat e Shqipërisë në nivel bashkiak dhe ka qenë vetëm një bashkiak dhe që është hequr në bazë të ligjit

### PROTESTA

"Më shumë se 50 gjyqtarë e magistratë të lidhur me afëra e të korruptuar, falë vetingut janë nxjerrë jashtë radhëve të sistemit e shumë të tjerë janë në radhë për t'u nënshtruar. Të gjithë nën sytë e një skuadre ekspertësh ndërkombëtarë. Si të mos ketë lëvizje të forta nga pjesë të pushtetit të vjetër kundër kësaj qeverie?"

të ri të dekriminalizimit, një lloj "Severini", por edhe më i fortë. Nuk më ka pëlqyer kurrë të flas në gjuhë të huaj për kundërshtarët e mi politikë, por ajo që i kanë bërë vendit këto javët e fundit, duke shpalosur dhunën ndaj institucioneve është e pafalshme.

### Kithehemi te kryebashkiakët. Kush nga ata që rezulton akoma nën hetim nga ana e akuzës do të rikandidohet në zgjedhjet e qershorit?

Sot asnjë nga bashkiakët tanë nuk janë nën hetim. E shihni se si gënjeshtar bëjnë xhiron e botës? **Sa ndiheni përgjegjës që dy nga ish-ministrat tuaj të Brendshëm janë hetuar?**

I pari është akuzuar mbi bazën e bisedimeve mes dy trafikantëve në një proces gjyqësor në Katania. Por, edhe pse ai sulm mbante erë, unë kërkova largimin e tij nga grupi parlamentar dhe nga i gjithë roli dhe angazhimi i tij në parti. Nderkohë, për vëllain e ministrit, kishin një dënim në Itali të shumë kohëve më parë, i pakryer, sepse shteti italian nuk kishte kërkuar ekstradi-

min.

### Me riorganizimin e qeverisë fituat ju, apo fituan studentët?

Unë nuk kam dashur kurrë të fitoj mbi njerëzit, por kam dashur dhe dua të bëj më të mirën për njerëzit dhe t'i dëgjoj ata. Studentët e dinin dhe ishte një moment intens, por edhe shumë i bukur i demokracisë sonë ende të re, të brishtë dhe jo perfekte.

### Pse shumë shqiptarë, veçanërisht të rinj shkojnë të punojnë në Gjermani?

Pse shumë italianë në jug shkojnë të punojnë në Veri? Dhe pse shumë mjekë italianë shkojnë në Gjermani e kështu me radhë? Përgjigja është e qartë: Shqipëria nuk është Italia, edhe pse italianë janë shqiptarët e veshur me "Versace". Kur ju kishit demokraci dhe zhvillim ekonomik, me ish-ministrat e Veriut e Evropës. Këto 30 vitet e fundit kemi bërë hapa gjigante në shumë drejtime, edhe pse kemi shkatërruar burime e bukuri. Sigurisht që kemi probleme dhe duhet të bëjmë shumë më shumë me sakrificë e durim kundër varfërisë, korrupsionit, kriminalitetit.



Shkresat e Kuvendit nuk bëjnë shpalljen e vakancave për 56 deputetët e dorëhequr

# Djegia e mandateve, variantet që po diskuton PS për të dalë nga kriza

Shumica po tenton të krijojë numrat për një Kuvend funksional

**K**omisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk ka përcaktuar ende një datë se kur do të marrë në shqyrtim 56 dorëheqjet e deputetëve të opozitës nga mandati i deputetit. Por, burime pranë tij kanë bërë me dije dje se dosja e paraqitur nga ana e Kuvendit me 56 njoftimet për deklarimin e dorëheqjeve të deputetëve të opozitës nuk është korrekte, pasi shkresat nuk përcaktojnë krijimin e vakancave, siç edhe parashikon ligji.

## DEBATI

Për këtë, ata kanë krahasuar shkresat e ardhura të premtën dhe shkresat e ardhura nga praktikantët e mëparshme, kur deputetët të ndryshëm kanë lënë mandatin e deputetit. Një rast i tillë është ai i ish-deputetit të PDIU-së, Bujar Muça, i cili dorëzoi mandatin si deputet i Elbasanit. Në këtë rast Kuvendi njoftoi KQZ-në me një shkresë ku thuhet: "Ju njoftojmë se deputeti Bujar Muça ka depozituar në Kuvendin e Shqipërisë dorëzimin e mandati të deputetit. Në mbështetje të nenit 71, pika 2 e Kushtetutës ka mbaruar. Bazuar në Kodin Zgjedhor, Kuvendi ju njofton për krijimin e vakancës nga ndërprerja e parakohshme e mandati, për të vijuar procedurën e zëvendësimit". Pra siç shihet, Kuvendi në këtë rast e ka përcaktuar qartë mbarimin e mandati dhe krijimin e vakancës për këtë deputet. Çka nuk ndodh në njoftimin për deklarimin e dorëheqjeve të 56 deputetëve të opozitës, që kanë shkruar në KQZ ditën e premtë. Kjo pasi në këto shkresa, që janë të njëjta për të gjitha rastet e 56 dorëheqjeve, Kuvendi shkurtimisht i shkruan KQZ-së: "Z. Sali Berisha deputet i Kuvendit të Shqipërisë ka paraqitur dorëheqjen nga mandati i deputetit. Në zbatim të Kodit Zgjedhor, ju përcjellim për kompetencë dokumentacionin përkatës". Pra, siç shihet, në këto raste Kuvendi nuk ka shpallur vakancat dhe ia ka lënë "topin" KQZ-së për të vepruar më tej. Por burime nga Kuvendi kanë



Dokument i dorëheqjes nga mandati i deputetit i z. Sali Berisha

## VARIANTI I

Varianti i parë është ai ligjor, pra që të vijohet me procedurën e plotësimit të vakancave të krijuara dhe zbatimin e ligjit deri në shterimin e kandidatëve në listat shumëmbrojtëse. Ky variant do të bënte fakt të kryer largimin e opozitës reale nga Kuvendi.

## SHKURT

### Mediu kthehet nga Vjena dhe firmos lënien e mandati të deputetit

Shkon në 57 numri i deputetëve të opozitës që kanë dorëzuar mandatin. Pas 56 dorëheqjeve të dorëzuara në grup në Kuvend nga kryetari i PD-së, Lulzim Basha dhe kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, dje ka ardhur edhe dorëheqja e kryetarit të Partisë Republikane, Fatmir Mediu. Ashtu siç kishte deklaruar, kreu i Partisë Republikane, Fatmir Mediu sapo është kthyer nga Vjena ku ndodhej bashkë me kryedemokratën Basha, ka firmosur dje deklaratën për dëgjimin e mandati të deputetit, duke iu bashkuar kështu opozitës së bashkuar. Mediu ndodhej për një vizitë zyrtare në Vjenë dhe Bruksel dhe për këtë arsye nuk i ishte bashkuar grupit të madh të deputetëve opozitarë, që ndërmorën aktin ekstrem pak ditë më parë. Një tjetër deputet i opozitës, Nard Ndoka, pritet të dëgjë mandatin e tij menjëherë pas kthimit nga Brukseli. Kjo, pasi Ndoka e ka konfirmuar një gjë të tillë publikisht më parë. Ndërkohë që nuk dihet ende se si do të veprjë deputetja tjetër demokratike, Rudina Hajdari, e cila gjithashtu deri më tani është justifikuar se ndodhet jashtë shtetit. Nga ana tjetër, dy deputetë të opozitës, Lefter Koka dhe Myslim Murrizi kanë deklaruar publikisht se nuk e dorëzojnë mandatin. Kjo solli edhe përfundimin e këtij të fundit nga Partia Demokratike dhe shkarkimin nga të gjitha funksionet që kishte në strukturat e PD-së.

### PD: Tahiri dhe Dako vodhën 26 mandate në Tiranë dhe Durrës

Partia Demokratike ka reaguar me anë të zëdhënësës Ina Zhupa, për investigimet e kryera nga mediat e huaja, të cilat kanë treguar format dhe mënyrat se si janë blerë votat në Shqipëri nga grupe kriminale. Ina Zhupa shprehet se blerja e zgjedhjeve, e faktuar tashmë, tregon qartë se kjo qeveri është ilegjitime, ndërsa rendit disa nga emrat e PS-së, të cilët sipas saj, kanë ndihmuar PS-në në sigurimin e mandateve përmes kësaj skeme. "Përgjimet italiane dhe përgjimet shqiptare, prova zyrtare në prokurori tregojnë qartë se si janë blerë votat në Shqipëri me grupet kriminale dhe pushtetarët të lidhur me ta. 'Zëri Amerikës' na bëri publike provat e Dakos, italianët provat e Tahirit. Zv.ambasadori i OSBE-së e pranon publikisht shtitblerjen e votës. Tahiri ishte koordinatori i Tiranës, ku PS mori 18 deputetë. Dako ishte koordinatori i Durrësit, ku PS mori 8 deputetë. Së bashku vetëm këta të dy kanë 26 deputetë për PS, që ndryshon çdo balancë të mazhorancës dhe opozitës, pa llogaritur fare qarqet e tjera të kapura në krim elektorral", - shprehet Zhupa. "Ndaj - thekson ajo - në asnjë vend demokratik, një mazhorancë e kapur në vjedhje nuk do të vijonte të qeveriste vendin".

## MANDATET

Loja me mosdeklarimin e vakancës mund të jetë pikërisht në funksion të këtij varianti, pasi krijon konfuzion ligjor, nuk lejon KQZ-në të veprjë me zëvendësimit dhe të pritje dorëheqjet e deklaruara nga deputetët e opozitës. Dhe kjo për të lënë mundësinë që në një të ardhme të afërt, me ndërhyrjen e ndërkombëtarëve, opozita të pranohet të rikthehet në parlament.

## MAZHORANCA

Ndërkohë që burime nga mazhoranca bëjnë me dije se janë duke u diskutuar disa variante për të menaxhuar situatën e krijuar nga djegia e mandateve nga ana e opozitës. Varianti i parë është ai ligjor, pra që të vijohet me procedurën e plotësimit të vakancave të krijuar dhe zbatimin e ligjit deri në shterimin e kandidatëve në listat shumëmbrojtëse. Ky variant do të bënte fakt të kryer largimin e opozitës reale nga Kuvendi. Varianti i dytë që po diskutohet është që mazhoranca të shfrytëzojë faktin që disa deputetë të opozitës nuk e kanë lënë mandatin dhe të synojë që bashkë me ndonjë element tjetër që mund të ndryshojë mendje rrugës dhe të heqë dorë nga lënia e mandati, të krijojë një shumicë prej 84 deputetësh në Kuvend. Kjo sipas tyre e bën Kuvendin funksional për të marrë ven-

Mazhoranca mund të shfrytëzojë faktin që disa deputetë të opozitës nuk e kanë lënë mandatin dhe mund të synojë që bashkë me ndonjë element tjetër që mund të ndryshojë mendje rrugës dhe të heqë dorë nga lënia e mandati, të krijojë një shumicë prej 84 deputetësh në Kuvend.

dime edhe me shumicë të cilësuar votash dhe i jep atij një farë legjitimiteti të pranuar edhe në sytë e ndërkombëtarëve. Ndaj, loja me mosdeklarimin e vakancës mund të jetë pikërisht në funksion të këtij varianti, pasi krijon konfuzion ligjor, nuk lejon KQZ-në të veprjë me zëvendësimit dhe të pritje dorëheqjet e deklaruara nga deputetët e opozitës. Dhe kjo për të lënë mundësinë që në një të ardhme të afërt, me ndërhyrjen e ndërkombëtarëve, opozita të pranohet të rikthehet në parlament. Këto janë dy variantet ligjore që mund të ndjekë shumica e majtë, pasi në tavolinë ekzistojnë edhe variante të tjera të zgjidhjes politike, që ka një marrëveshje me PS dhe PD, e deri të zgjedhjet e parakohshme.

## INTERVISTA KRIZA

Kryetarja e PS-së së Tiranës: Shqiptarët nuk e meritojnë këtë opozitë

# Gjylameti: Do vazhdojmë jetën tonë politike, dialog brenda rregullave

"Veliaj kandidat? Do e përcaktojë analiza e strukturave"

Kryetarja e Partisë Socialiste për kryeqytetin, deputetja, Blerina Gjylameti në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", tekson analizën situatën politike të krijuar pas protestës së opozitës dhe lënies prej saj të mandateve të deputetëve, ashtu si kryeministri Rama, shkaqet e lidhjeve me reformën në drejtësi dhe sondazhet parazgjedhore të mbështetjes që gëzojnë në popull. Sipas saj, shqiptarët nuk e meritojnë kurrë një opozitë të tillë, që prish kontratën me popullin për të shtuar në tavolinë kontratën për pushtetin. "Opozita duhet të kthehet në vatrën e saj të reflektimit për të hequr dorë nga dëgjia e kontratës me popullin, apo interesin e ngushtë me pushtetin dhe për t'u vendosur përballë në mënyrë demokratike. Thelbi i demokracisë ndahet midis votës dhe sovranit".



brendshme partiake dhe organizimin elektoral, ajo vlerëson punën e bërë në Tiranë nga Veliaj, por duke theksuar se kandidimi i tij do vendoset pas analizës që do bëhet në strukturat partiake. "Tirana ka ndryshuar jashtëzakonisht. Këtë e dëgjoj në çdo takim me qytetarët dhe jo vetëm e dëgjoj, por shoh dhe bilancin e krahasimit që ata bëjnë me atë që ishte dhe atë që është. Tirana sot rreshtohet në kryeqytetet me një nivel në rritje të standardit evropian dhe kjo falë punës së madhe të ekipit të Bashkisë së Tiranës dhe mbështetjes së qeverisë socialiste. Analiza nga struktura mbi performancën e gjithsecilit nga kryebashkiakët do të përcaktojë dhe kandidaturën e duhur", - shprehet Gjylameti. Duke folur për ndryshimet në qeveri, ajo thekson se emrat e rinj do të sjellin një energji të re në qeverisjen e vendit. "Unë nuk i shoh jashtë, përkundrazi kontributi i tyre i djeshëm në krye të ministrive dhe pjesë e pandashme e ekipit i dha 74 mandate Partisë Social-

iste, e tashmë të dedikuar tërësisht në bazë për t'i dhënë fitoren në 61 bashki të vendit. Përsa i përket ndryshimeve në qeveri, ajo që lexoj unë është pikërisht ajo që tha kryem-

### DIALOGU

"Presidenti ka dekretuar tashmë datën e zgjedhjeve vendore dhe ne po punojmë me strukturat tona për të ofruar kandidatët më përfaqësues. Nga ana tjetër, ne kemi hapur urën e dialogut për të zgjidhur situatën brenda rregullave të lojës, që i kemi gjetur edhe kur nuk kemi qenë në këto kushte".

ministri, nevoja për një energji të re përballë sfidave që ne kemi përditë me qytetarët", - thotë Gjylameti.

**Zonja Gjylameti, zhvillimet politike në vend kanë marrë një kthesë të papritur që nga protesta e 16 shkurtit, ku nuk munguan as aktet e dhunës ndaj godinës së institucionit të Kryeministrit. Pas saj, opozita ndërmoi edhe aktin e dorëzimit të**

### OPOZITA

"Opozita duhet të kthehet në vatrën e saj të reflektimit për të hequr dorë nga dëgjia e kontratës me popullin, apo interesin e ngushtë me pushtetin dhe për t'u vendosur përballë në mënyrë demokratike. Thelbi i demokracisë ndahet midis votës dhe sovranit".

### mandateve të deputetëve të vet. Keni një koment për këtë situatë?

Mendoj se ky është një akt i paprecedent i ndodhur në historinë e parlamentarizmit në demokracinë shqiptare. Mendoj se demokracia në thellim funksionim të saj duhet ta ketë opozitën, por shqiptarët nuk e meri-

tojnë kurrë një opozitë të tillë, që prish kontratën me popullin për të shtuar në tavolinë kontratën për pushtetin. Opozita duhet të kthehet në vatrën e saj të reflektimit për të hequr dorë nga dëgjia e kontratës me popullin apo interesin e ngushtë me pushtetin dhe për t'u vendosur përballë në mënyrë demokratike. Thelbi i demokracisë ndahet midis votës dhe sovranit.

**Çfarë do ndodh tashmë te j, a është e mundur**



Kryeministri Edi Rama dhe deputetja Blerina Gjylameti

### që të qeveriset pa prezencën e opozitës në parlament?

Mendoj se ishte e qartë edhe në deklaratën që kryeministri Rama ka bërë pas aktit të dëgjies së mandateve nga opozita. Ne kemi një vend që kemi prej 30 vitesh një Kushtetutë që e përvetësojmë edhe më tepër, duke u referuar paketa juridike të perëndimit. Siç thashë, akti është i paprecedent dhe në një mënyrë apo në një tjetër, komenti i vetëm që unë kam është që ne do të vazhdojmë jetën tonë politike, duke respektuar votën e atyre që na kanë zgjedhur, sepse kjo është e vetmja mënyrë për të treguar se ne respektojmë institucionet.

**Opozita ka parashtruar ndër të tjera si kërkesë të panegociueshme krijimin e një qeverie tranzitore, për të bërë të mundur zhvillimin e zgjedhjeve lokale dhe atyre të parakohshme parlamentare në të njëjtën kohë. A e përjashtoni ju një marrëveshje tjetër politike mes mazhorancës dhe opozitës për të shtyrë datën e zgjedhjeve lokale dhe mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme?**

Presidenti ka dekretuar tashmë datën e zgjedhjeve vendore dhe ne po punojmë me strukturat tona për të ofruar kandidatët më përfaqësues. Nga

ana tjetër, ne kemi hapur urën e dialogut për të zgjidhur situatën brenda rregullave të lojës, që i kemi gjetur edhe kur nuk kemi qenë në këto kushte.

### Po nëse opozita nuk merr pjesë në zgjedhjet vendore, a do mbahen ato?

Kam bindjen se opozita do të marrë pjesë në zgjedhje.

### Cila besoni se është arsyeja e vërtetë e opozitës për këto hapa drastike, sidomos kur jemi para zgjedhjeve vendore?

Natyrisht më vjen të them se prej kohësh ka një përpjekje koherente nga ana e tyre për të penguar reformën në drejtësi. Nga ana tjetër, mendoj se opozita nëpërmjet sondazheve ka matur edhe humbjen e radhës dhe kjo mbase e ka çuar në këtë vendim ekstrem, me mendimin se kështu mund të prish zgjedhjet apo të fitoj kapital politik. Gjë e cila nuk duket produktive.

### Sa e rrezikon kjo situatë marrjen e statusit të vendit kandidat nga ana e Shqipërisë në muajin qershor?

Mendoj se çdo situatë që nuk u shërben hapave të procesit të integritimit e prish imazhin dhe pengon punën e që deri tani është bërë për reformimin e vendit. Shqipëria ka bërë një nga hapat më të vlerësuar nga institucionet përfaqësuese të BE-së, reformën në drejtësi. Pikërisht këtë



Rama: Ata nuk janë më pala tjetër e parlamentit, po një grusht politikanësh pa norma

# Ministrat dhe deputetët socialistë urdhër, jo më debate me opozitën

“Për sharjet e shpifjet e tyre, ata s'kanë nevojë për ne”

Lënia e mandateve të deputetëve dhe dalja nga Kuvendi për kryeministrin, Edi Rama duhet të shënojë edhe daljen e opozitës nga debati politikë me mazhorancën. Burime nga Partia Socialiste kanë bërë të ditur se ai u ka kërkuar ministrave dhe deputetëve të tij të shmangin tashmë të gjitha debatet televizive me deputetë dhe përfaqësues të PD dhe LSI. Kjo, pasi tashmë ata kanë hequr dorë nga mandatet dhe sipas kryeministrit Rama, ata në mënyrë të vullnetshme kanë zgjedhur që të mos të jenë më pala tjetër e debatit politikë në përgjithësi dhe atë mediatic në veçanti. Pra, duket se kemi të bëjmë me një ndry-



shim të strategjisë së komunikimit nga ana e socialistëve, të cilët nuk duan që të bien preh e debateve pa norma të përfaqësuesve të

PD dhe LSI. Për këtë mësohet se kreu i qeverisë, Edi Rama, u ka përcjellë të gjithë ministrave dhe deputetëve porosinë për të mos dalë më

## DEBATI

"Për sharjet e shpifjet e tyre, ata s'kanë nevojë për ne dhe kështu kontribuojmë kundër ndotjes së mjedisit publik, me debate shterpë pa asnjë vlerë", - ka vijuar më tej kryeministri argumentin e tij.

hap do të rrezikojë dhe opozita si në qershor dhe jo vetëm. Ne duhet të kuptojmë rrezikun populist të opozitës, që për hir të kapitalit politik kërkon të pengojë integrimin. Megjithatë, ne besojmë se leksioni i përbashkët i shoqërisë sonë për nevojën e progresit nuk do ta marrë seriozisht tentativën e shëmtuar të opozitës. Shqipëria i përket Europës dhe Perëndimit.

**Meqë jemi te çështja e zgjedhjeve, kryeministri**

tarisë sonë do të analizohet dhe në çastin e duhur do të ketë një përgjigje. Ajo që ia vlen të theksohet është se Partia Socialiste është e kërkuese nga vetja dhe do të bëjë përpjekje të vazhdueshme për të nxjerrë përpara qytetarëve kandidatët më të denjë.

**Ndërkohë që ju jeni kryetare e PS-së së Tiranës dhe natyrisht që një nga çështjet që diskutohet më shumë është edhe ajo e kandidaturës së Erion Veliajt. Ju mendoni se Veliaj**

**"Tirana sot rreshtohet ndër kryeqytetet me një nivel në rritje të standardit evropian dhe kjo falë punës së madhe të ekipit të Bashkisë së Tiranës dhe mbështetjes së qeverisë socialiste.**

**Analiza nga struktura mbi performancën e gjithsecilit nga kryebashkiakët do të përcaktojë dhe kandidaturën e duhur".**

nga struktura mbi performancën e gjithsecilit nga kryebashkiakët do të përcaktojë dhe kandidaturën e duhur.

**Po sa i përket organizimit elektoral të partisë në kryeqytet, si po ecën procesi dhe a ka sondazhe PS-ja se si është mbështetja te qytetarët?**

Partia Socialiste nuk ndalon në procesin e saj të organizimit. Ne jemi në çdo kohë në komunikim me strukturat përfaqësuese. Di të them që e gjithë vëmendja jonë është te njerëzit, sepse ka një kërkesë të vazhdueshme nga qytetarët për të qenë

## STATUTI

Jemi në diskutime të vazhdueshme për të përmirësuar vetveten dhe rregullat tona të lojës, të cilat duhet t'i paraqiten kongresit. Angazhimi i çdo pjesëtari të ekipit të Partisë Socialiste në detyrat që i janë ngarkuar është maksimal për të realizuar pritshmërinë jo vetëm të strukturave, por mbi të gjitha të qytetarëve

pranë tyre. Socialistët gëzojnë mbështetje të qenësishme, e cila në çdo kohë vazhdon e shtohet.

**Në krahun tjetër politik, opozita po riorganizohet në një koalicion të gjerë, ku janë përfshirë shumë parti politike, çka duket se e ka bërë të pamundur që në krahun tjetër, PS të krijojë një koalicion të vetin, pasi partitë që kanë mbetur jashtë këtyre organizimeve janë ose shumë pak, ose shumë të vogla. A do krijojë PS një koalicion dhe cilat parti do synohen të përfshihen në të?**

Partia Socialiste prej 2017-ës ka një koalicion me qytetarët. Pjesa tjetër i përket punës sonë brenda strukturave, çka do të bëhet e ditur në kohën dhe vendin e duhur.

Zonja Gjylameti, kryeministri Rama pak javë më parë ndryshoi më shumë se gjysmën e kabinetit qeveritar, ku shumë emra që u bënë pjesë e tij ishin thujtase anonim. Si i shihni këto ndryshime dhe a është normale që politikanët e karrierës në PS janë lënë jashtë qeverisë?

Unë nuk i shoh jashtë, përkundrazi kontributi i tyre i djeshëm në krye të ministrave dhe pjesë e pandashme e ekipit i dha 74 mandate Partisë Socialiste, e tashmë të dedikuar tërësisht në bazë për t'i dhënë fitoren në 61 bashki të vendit. Përsa u përket ndryshimeve në qeveri, ajo që lexoj unë është pikërisht ajo që tha kryeministri, nevoja për një energji të re përballë sfidave që ne kemi përditë me qytetarët.

**Ju jeni pjesë edhe e grupit të punës për ndryshimet në statut. A është mbledhur ky grup pune dhe ku konstatojnë këto ndryshime?**

Jemi në diskutime të vazhdueshme për të përmirësuar vetveten dhe rregullat tona të lojës, të cilat duhet t'i paraqiten kongresit. Angazhimi i çdo pjesëtari të ekipit të Partisë Socialiste në detyrat që i janë ngarkuar është maksimal për të realizuar pritshmërinë jo vetëm të strukturave, por mbi të gjitha të qytetarëve që besuan në programin tonë dhe në aleancën për të bashkëqeverisur.

në asnjë studio televizive me të ikurit. "Ata s'janë më pala tjetër e parlamentit, po një grusht politikanësh pa norma, që meritojnë përbuzjen e votuesve të tyre dhe refuzimin tonë për të debatuar me ta jashtë parlamentit", - mësohet të ketë thënë Rama gjatë një mbledhjeje me bashkëpunëtorët më të ngushtë. "Për sharjet e shpifjet e tyre, ata s'kanë nevojë për ne dhe kështu kontribuojmë kundër ndotjes së mjedisit publik, me debate shterpë pa asnjë vlerë", - ka vijuar më tej kryeministri argumentin e tij. Pavarësisht situatës së vështirë politike, mazhoranca ka vijuar procesin e saj të organizimit elektoral, teksa kryeministri Rama ka ndërmarrë dhe një tur takimesh në bazë. Ndërkohë që edhe në mbledhjen e shkuar të grupit parlamentar, ai porosiit deputetët e vet që të vijojnë të punojnë për organizimin e zgjedhjeve dhe t'u shmangen debateve që nuk sjellin produktivitet. Publikisht kryeministri është shprehur i gatshëm të dialogojë me opozitën për gjetjen e një zgjidhjeje të këtij ngërçi, ndërsa ka bërë të qartë se nuk do pranojë asnjë kërkesë që ka të bëjë me ndërprerjen e mandatit qeverisës dhe zgjedhjet e parakohshme.

Nga ana tjetër, opozita shqiptare ka nisur një valë protestash kundër qeverisë me synimin sipas tyre, për të rrëzuar kryeministrin Edi Rama, qeveri transitore dhe më tej zgjedhjet e parakohshme. Pas dy protestave të para, assj të datës 16 dhe 21 shkurt, ajo ka vendosur që të organizojë protesta çdo të enjte para Kuvendit, në mënyrë që të mos lejojë një funksionim normal të tij.

## PROTESTA

"Akti është i paprecedent dhe në një mënyrë apo në një tjetër, koment i vetëm që unë kam është që ne do të vazhdojmë jetën tonë politike duke respektuar votën e atyre që na kanë zgjedhur, sepse kjo është e vetmja mënyrë për të treguar se ne respektojmë institucionet".

**Edi Rama ka ndërmarrë një tur takimesh në bashki të ndryshme, ku duket se po konfirmon një pjesë të kandidatëve për kryetar bashkie. Ndërkohë që ka një debat nëse duhet të rikandidojnë më ata kryebashkiakë që kanë më shumë se dy mandate. Ju çmendim keni për këtë gjë?**

Prej kohësh ne jemi në komunikim të vazhdueshme me strukturat dhe me anëtarësinë. Çdo mendim rreth veprim-

**duhet të rikandidojë për një mandat të dytë?**

Unë mendoj se Tirana ka ndryshuar jashtëzakonisht. Këtë e dëgjoj në çdo takim me qytetarët dhe jo vetëm e dëgjoj, por shoh edhe bilancin e krahasimit që ata bëjnë me atë që ishte dhe atë që është. Tirana sot rreshtohet në kryeqytetet me një nivel në rritje të standardit evropian dhe kjo falë punës së madhe të ekipit të Bashkisë së Tiranës dhe mbështetjes së qeverisë socialiste. Analiza

Ngjarja në zonën e ish-Kënetës. Krismat alarmuan lagjen, si ndodhi vrasja

# Vritet me 5 plumba mirditori Martin Ndreca

Klodiana Haxhiaj

Një 45-vjeçar është gjetur i pajetë në një automjet tip "Benz", në zonën e ish-Kënetës. Vrasja ka ndodhur rreth orës 01:10 duke gdhirë e diela, ndërsa viktimën u identifikua si Martin Ndreca me origjinë nga Mirdita. Policia e Durrësit ka identifikuar autorin dhe është vënë në ndjekje të tij. Ngjarja dyshohet se ka ndodhur për motive të dobëta dhe ka si autor Ndue Zefi, 37 vjeç.

## DETAJET

Sipas të dhënave policore, bëhet me dije se viktimën dhe autori njiheshin me njëri-tjetrin, madje para vrasjes kishin qenë të ulur bashkë në lokal në lagjes. Pikërisht aty, teksa pinin ka nisur një konflikt mes tyre. Mësohet se ata nuk janë konfliktuar fizikisht, por kur janë ngritur, autori Ndue Zefi, 37 vjeç, ka shkuar në banesën e tij dhe ka marrë kallashnikovin për të "larë hesapet". Ai i ka zënë priturë fqinjët të tij, Martin Ndreca, 45 vjeç dhe e ka qëlluar. Mbi trupin e viktimës janë derdhur pesë plumba, zhurma e të cilave ka zgjuar të gjithë lagjen. Kanë qenë banorët e zonës, ata që e kanë gjetur të pajetë 45-vjeçarin si dhe kanë lajmëruar me pas policinë. Pas hetimeve, blutë e Durrësit kanë mundur të identifikojnë dhe shpallin në kërkim autorin e dyshuar të ngjarjes. Për momentin mbeten ende të paqarta motivet që e shtynë 37-vjeçarin të ekektonte me 5 plumba fqinjin e tij.

*Sherri mes fqinjëve nisi në lokal, në kërkim Ndue Zefi 37 vjeç*



## DESHMITARET

"Martin Ndrecën e njihja dhe kishim bashkë origjinë të njëjtë nga Mirdita.

Kur në lagje plasën krismat, të gjithë dolëm të alarmuar nga shtëpitë dhe lajmëruam direkt policinë. Shumë e rëndë është të vrasësh një njeri për një fjalë goje, por edhe sikur të ketë bërë më shumë, vdekjen s'e meriton kush", - thotë një prej banorëve në zonën e ish-Kënetës, pas vrasjes së 45-vjeçarit.

## Drejtorja: Inspektim tragetit dhe gjendjes teknike

### Defekti në traget, 280 pasagjerë kalojnë tri orë ankthi në det

280 pasagjerë të tragetit "Rigel 1" kanë kaluar tri orë ankthi në det të hapur mbrëmjen e shkruar Kapiteni i portit, Taulant Allka, bëri me dije se një problem me paketën e kontrollit brenda në tragetin e linjës Durrës-Bari ka bërë që trageti të pësojë "black out" në orën 03:00 të mëngjesit. Kapiteni ka ndezur manualisht një prej motorëve duke sjellë energjinë elektrike për pasagjerët e traumatizuar e në panik. Kapiteni i tragetit ka qëndruar për rreth 3 orë në det të hapur deri sa të bëhej e mundur ftohja e motorëve për të ndërhyrë në riparimin e defektit në sistemin e kontrollit, por aspak favorizues ka qenë edhe moti. Si rezultat i erës se



fortë, trageti është zhvendosur drejt Barit, ndërsa ishte nisur mbrëmë nga Bari në drejtim të Durrësit. Avaria e pësuar ka bërë që pasagjerët të qëndrojnë në det të hapur deri në riparimin e defektit, një pjesë e të cilëve e kanë denoncuar tek autoritetet italiane. "Guardia di finanza" dhe roja bregdetare italiane kanë qenë në gatishmëri për të ndërhyrë në rast rrezik

mbytyjeje. Rreth orës 6 të mëngjesit trageti është nisur pas vënies në funksion dhe riparimit të defektit. Për ngjarjen ka reaguar edhe Drejtorja e Përgjithshme Detare përmes një deklarate për mediat, ku thuhet se ata do të dërgojnë grupin e Kontrollit Shtetëror Portual për të bërë inspektimin e tragetit dhe gjendjes teknike të tij.

**BalkanWeb.com**

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

**BalkanWeb.com**  
**BW**

FALAS



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BANKA E SHQIPERISE  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

## TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të ashensorëve në godinat e Bankës së Shqipërisë"

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 1,840,000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në Illogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutiesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të ashensorëve në godinat e Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 19 Mars 2019, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

## PENSIONET E USHTARAKËVE NDRYSHIMET NË LIGJ

Voltiza Duro

Të gjithë ushtarakëve iu ka lindur e drejta e përfitimit të rritjes së pensionit në masën e indeksuar prej 2.8%. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot 8 kategoritë e ushtarakëve që do të përfitojnë nga vendimi i qeverisë, si dhe mënyrën e saktë si mund ta llogarisin masën e pensionit pas indeksimit. Ky i fundit do të bëhet në bazë të rishikimit të ligjit "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të caktuara me nenin 21, të këtij ligji. "Këshilli i Ministrave vendosi indeksimin, në masën 2.8 për qind, të: pensioneve të caktuara me dekretin nr.758, datë 1.2.1994, të Presidentit të Republikës, 'Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut', trajtimeve të veçanta financiare, të caktuara sipas ligjit nr.9361, datë 24.3.2005, 'Për një trajtim të veçantë financiar të efektive, oficerë dhe nënoficerë, lundruar në nëndetese dhe palombarëve të forcave detare në pension', - thuhet në vendim. Më tej në këtë të fundit bëhet me dije se nga kjo rritje do të preken edhe trajtimet e veçanta financiare të caktuara sipas ligjit nr.9179, datë 29.1.2004, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake". Ndërkohë indeksimin e përfitojnë edhe pensionet që do të caktohen nga data 1.7.2018 e në vazhdim, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë deri më 30.6.2018, përfshirë edhe këtë datë. "Shuma bazë e pensionit, e përcaktuar sipas pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, duke filluar nga data 1.7.2018 e në vazhdim të jetë 7 262 lekë. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi për llogaritjen në shumën 1 545 000 000 lekë dhe përballohen nga fondit për politikë e indeksimit të pensioneve, i parashikuar në buxhetin e ISSH-së të vitit 2018", - nënvizohet më tej në vendim.

### LLOGARITJA

Llogaritja e një pensioni suplementar të pleqërisë bëhet sipas formulës: PSP = PMRMN x VSH x 1% ku PSP

ISSH sjell shembujt konkretë: Kujdes, cila është formula e saktë e përlllogaritjes

# Vendimi i qeverisë: Sa do të rriten pensionet e ushtarakëve

Zbardhen 8 kategoritë që do të marrin më shumë para



### FORMULA

Llogaritja e një pensioni suplementar të pleqërisë bëhet sipas formulës: PSP = PMRMN x VSH x 1% ku PSP nënkupton pensionin Suplementar të Pleqërisë, PMRMN është Paga Mesatare Referuese Mujore Neto, ndërsa VSH janë vitet e Shërbimit.

### TRAJTIMET E VEÇANTA

Nga kjo rritje do të preken edhe trajtimet e veçanta financiare të caktuara sipas ligjit nr.9179, datë 29.1.2004, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake".

### PERLLOGARITJA

Llogaritja e një pensioni suplementar të pleqërisë bëhet sipas formulës: PSP = PMRMN x VSH x 1% ku PSP nënkupton pensionin Suplementar të Pleqërisë; PMRMN është Paga Mesatare Referuese Mujore Neto; ndërsa VSH janë vitet e Shërbimit. Por, masa që rezultojnë nga kjo formulë nuk duhet të jetë më shumë se 50 për qind e pensionit të pleqërisë.

nënkupton pensionin Suplementar të Pleqërisë; PMRMN është Paga Mesatare Referuese Mujore Neto; ndërsa VSH janë vitet e Shërbimit. Por, masa që rezultojnë nga kjo formulë nuk duhet të jetë më shumë se 50 për qind e pensionit të pleqërisë. Nëse një ushtarak përfiton pension pleqërie sipas Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar dhe masën 26,000 lekë në muaj, ai ka 28 vite shërbimi si ushtarak dhe pagë mesatare referuese mujore neto 53,700 lekë në muaj. Llogaritja e pensionit suplementar të pleqërisë bëhet në këtë mënyrë: PSP = 53,700 lekë x 28 vite x 1% = 15,036 lekë / muaj. Por, pensioni suplementar i pleqërisë nuk duhet të jetë më i lartë se 50% e pensionit të pleqërisë që

ushtaraku gëzon, në çastin e lindjes së të drejtës së pensionit suplementar. Kështu, ushtaraku përfiton pension pleqërie në masën 26,000 lekë/muaj. Në këtë rast, pensioni suplementar i pleqërisë është sa 50% e pensionit të pleqërisë, pra 13,000 lekë/muaj. Pra, ish-ushtaraku do të përfitojë pension suplementar pleqërie në masën 13,000 lekë lekë/muaj.

### PËRFITUESIT

Edhe ushtarakët që kanë punuar në një prej institucioneve të përcaktuara me ligj kanë të drejtën e përfitimit të pensionit suplementar. Sipas Institutit të Sigurimeve Shoqërore, përfitim

Edhe ushtarakët që kanë punuar në një prej institucioneve të përcaktuara me ligj kanë të drejtën e përfitimit të pensionit suplementar. Sipas Institutit të Sigurimeve Shoqërore, përfitim suplementar kanë të drejtë të marrin të gjithë ushtarakët e Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, punonjësit e Policisë së Shtetit, ata të Gardës së Republikës, punonjësit e Shërbimit Informativ të Shtetit si dhe ata të Policisë së Burgjeve.

qipërisë; punonjësit e Policisë së Shtetit; ata të Gardës së Republikës, punonjësit e Shërbimit Informativ të Sh-

### KATEGORITË PËRFITUESE:

- Ushtarakët e Forcave të Armatosura në RSH.
- Punonjësit e Policisë së Shtetit.
- Punonjësit e Gardës së RSH.
- Punonjësit e Shërbimit Informativ të Shtetit.
- Punonjësit e Policisë së Burgjeve.
- Punonjësit e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit.
- Punonjësit e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm.
- Punonjësit e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

tetit si dhe ata të Policisë së Burgjeve. Gjithashtu, nga pensioni suplementar mund të përfitojnë edhe punonjësit e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, ata të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm si dhe punonjësit e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes. Sipas ligjit, ka disa lloj përfitimesh që administrohen nga ISSH-ja, e respektivisht bëhet fjalë për pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi, pensionin suplementar të pleqërisë, pensionin suplementar të invaliditetit, si dhe për atë familjar. Kështu, për të përfitur pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi, burrat duhet të kenë mbushur moshën 47 vjeç e të kenë jo më pak se 15 vite pune, ndërsa gratë

duhet të jenë mbi 42 vjeç e të kenë jo më pak se 12 vite shërbimi. Ndërkohë, mund të përfitojnë pensionin suplementar pleqërie të gjitha kategoritë e sipërpërmendura dhe pensioni suplementar i invaliditetit po këto kategori që janë deklaruar invalidë dhe përfitojnë pensionin i invaliditetit të plotë apo të pjesshëm, sipas Ligjit nr. 4171, "Për sigurimet shoqërore të RPSH" dhe Ligjit nr. 7703, "Për sigurimet shoqërore në RSH". Instituti i Sigurimeve Shoqërore bën me dije se kur personat e familjes në ngarkim të personave të sipërpërmendur dhe familjet e ushtarakëve që humbasin jetën në krye të detyrës e përfitojnë pensionin familjar, sipas ligjit kanë gjithashtu të drejtën e marrjes së pensionit suplementar familjar.

Mbretëria e Bashkuar ka numrin më të madh të përdoruesve të rinj të kokainës në Evropë

# 'The Mirror': Mafia shqiptare në Britani kontrollon tregun e kokainës

*"Arrijnë të ulin çmimin duke rritur pastërtinë e mallit"*

Tregu britanik domi nohet nga mafia e pamëshirshme shqiptare. Madje, fitimet e tyre arrijnë në 5 miliardë paund. Banditë të frikshëm nga vendi ballkanik kontrollojnë pothuajse të gjithë tregun në Britaninë e Madhe, shkruan "The Mirror". Mafia shqiptare ka arritur tashmë të kthehet në një "tregtare me shumicë", duke negociuar direkt me kartelet kolumbiane. Kjo i ka lejuar të ulin çmimin, duke rritur pastërtinë e mallit. Mbretëria e Bashkuar tani ka numrin më të madh të përdoruesve të rinj të kokainës në Evropë, shkruan "The Mirror". Në shkrim i kushtohet rëndësi një bande famëkeqe të pagëzuar si "Hellbanianz". Banda që ka rreth 50 anëtarë poston shpesh foto në mediat sociale, ku tregohet tufat e parave dhe makina të shtrenjta. Banda kishte 115.000 ndjekës në "Instagram" përpara se llogaria e saj të mbyllej në nëntor.



Kur "Mirror" nisi hetimet, qytetarët që banonin afër ndërtesës ku ata kryenin

aktiviteti dëshmuar se: "Ka 50 ose 60 anëtarë kjo bandë. 'Hellbanianz' nuk janë fëmijë, shumë prej tyre janë mbi të 20-at. Unë i shoh ata kur xhirojnë

## "THE MIRROR"

Banditë të frikshëm nga vendi ballkanik kontrollojnë pothuajse të gjithë tregun në Britaninë e Madhe, shkruan "The Mirror". Mafia shqiptare ka arritur tashmë të kthehet në një "tregtare me shumicë", duke negociuar direkt me kartelet kolumbiane. Kjo i ka lejuar të ulin çmimin, duke rritur pastërtinë e mallit. Mbretëria e Bashkuar tani ka numrin më të madh të përdoruesve të rinj të kokainës në Evropë, shkruan "The Mirror".

videot. I ngrenë makinat lart, dalin me maska dhe fillojnë veten". Një zëdhënës i Agjencisë Kombëtare të Krimin tha: "Grupet e krimin shqiptar kanë krijuar një profil dhe shkallë të lartë ndikimi brenda krimin të organizuar në Mbretërinë e Bashkuar dhe kanë qasje të konsiderueshme në tregun e trafikimit të drogës Britani, veçanërisht për sa i përket kokainës. Grupet e krimin të organizuar shqiptar duket se janë të zotë në krijimin e lidhjeve me grupe të tjera për të kryer biznesin kriminal, që përfshin trafikimin e drogës dhe armëve të zjarrit, pastrimin e parave dhe trafikimin e qenieve njerëzore", shkruan "The Mirror".

## Aksidenti në Fushë-Krujë, vdes i riu

Pas aksidentit të rëndë që ndodhi rreth orës 04:30 minuta të ditës së djeshme, kur një fuoristradë doli nga rruga dhe u përplas me bordurën e një karburanti, humb jetën njëri prej të rinjve që udhëtonin në të. Ndonëse tre të rinjve iu dha ndihma e menjëhershme, pasagjeri Altin Vogli nuk ka mundur t'u mbijetojë plagëve të marra dhe ka ndërruar jetë në Spitalin e Traumës. Të plagosur rëndë kanë mbetur 2 të rinjtë, Ilir Gega (shoferi) dhe miku i tij, Dorjan Hifi (pasagjer). Shkak i aksidentit, sipas të dhënave të para të policisë është bërë shpejtësia e lartë.

## Humb jetën në krye të detyrës elektrikisti, skandali

Një elektrikist ka humbur jetën në Fierzë pasi ra në kontakt me energjinë elektrike. "BalkanWeb" mëson se elektrikisti që ka humbur jetën është identifikuar si Prend Ceca, 36 vjeç. Ai kishte hipur në një shtyllë dhe po riparonte një defekt. Familjarët dhe të afërmit shprehen se nuk kanë asnjë ndihmë nga OSHEE dhe nga Policia e Shtetit. Armir Mehta raporton se elektrikisti, Prend Ceca, ishte nisur i vetëm për të riparuar defektet e shkaktuar nga erërat e forta, ndërsa prej orës 14 kishte ndërprerë kontaktet me familjarët. Edhe pse familjarët bëjnë të ditur se kanë njoftuar policinë dhe OSHEE ende askush nuk ka mbërritur për të zbritur trupin e pajetë të 34-vjeçarit nga shtylla ku humbi jetën në krye të detyrës.

## Vrasësit e ish-policit mund të gjenden nga ADN-ja

Vrasësit e ish-policit Arben Bilali mund të gjenden nga ADN. Sipas burimeve nga grupi hetimor, tek armët që autorët kanë lënë në makinë janë gjetur gjurmë ADN-je dhe të gishtave. Pas vrasjes në Tiranë, autorët u larguan me shpejtësi, duke tentuar që të djegin makinën me provat në Mjull të Bathores, por pavarësisht se e spërkatën me benzinë, nuk arritën që ta digjinin, pasi policia arriti me shpejtësi. 50-vjeçarit u ekzekutua me armë zjarri pranë shtëpisë në datë 30 janar. Ai sapo zbriti nga një automjet tip "Volkswagen Golf" me targa të huaja dhe po ecte në drejtim të trotuarit, pranë banesës, kur iu afrua një automjet tip "Mercedes Benz S" i zi me targa të falsifikuara dhe e qëlloi me breshëri 14 herë.



## ERA SHKATËRRON SHTEPITË NË GRAMSH, 6 FAMILJE NË QIELL TË HAPUR

Tri shtëpi raportohet se janë shkatërruar si pasojë e erës e fuqishme, e cila ka kapluar disa zona në qytetin e Gramshit. Gazetari i "BalkanWeb", Shkëlzen Henkoja raporton se gjashtë familje kanë mbetur në qiell të hapur, pasi mbremjen e djeshme era e fuqishme ka shkatërruar tri shtëpi dykatëshe. Gjatë ditës së shtunë e të diel, vendi ynë ka qenë i "mbërthyer" nga erërat e forta dhe temperaturat e ulëta, situatë kjo që ka shkaktuar probleme në shumë qytete e fshatra.



FOTOLAJM

## SHPLLAJE ANKANDI

Zyra Permbartimore "E.G Bailiff Service" me përmbartues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 20.03.2019 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i II-të për shlyerjen e pasurisë së paluajtshme, Apartament me sipërfaqe totale 86,35 m<sup>2</sup>, me numër pasurie 2/139/ND+1-13, volumni 71, faqe 142, zona kadastrale 8518, me adresë Lajçaj 13, Plazh, Hyrja 1, Ap.13 Durrës, në pronësi të Z.Çilrim Sejfulla Xhafa dhe Znj.Bardha Xhema Xhafa me vlerë fillestare në ankand 22.727.6 (Njëzet e dy mijë e shtatëqind e njëzet e shtatë pikë gjashtë) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 88 3188. email enuar.merko@gmail.com



## LOTARIA AMERIKANE FITUESIT E 2019-ës

Voltiza Duro

Të gjithë ata që janë shpallur fitues të lotarisë amerikane DV 2019-të, duhet të kontrollojnë vazhdimisht 'email'-in për të verifikuar nëse KÇ u kërkon dokumentacionin. Ky njoftim është bërë ditën e djeshme nga ambasada amerikane në Tiranë, e cila thekson se kandidatët duhet të mbajnë nën vëzhgim buletin e vizave. "Të përzgjedhur të Lotarisë DV2019: kontrolloni buletin e vizave për të parë se kur çështja juaj do të jetë gati për intervistë, si dhe kontrolloni rregullisht 'email'-in tuaj për një 'email' nga KÇ ku kërkohet t'i dërgoni dokumente me 'email'", - bën me dije ambasada. Pasi KÇ merr dhe përpunon formularin e aplikimit DS-260 për aplikantin dhe anëtarët e familjes shoqëruese, do të merren udhëzime se si të skanohen dhe ngarkohen dokumentet mbështetëse të nevojshme. Intervista nuk do të caktohet derisa të dorëzohen kopjet e skanuara të të gjitha dokumenteve të kërkuara, duke ndjekur udhëzimet. Fituesi duhet të sjellë dokumentet origjinale në intervistën me zyrtarin konsullor. Rekomandohet që të fillojë këtë proces në fillim. Aplikanti dhe secili anëtar i familjes që do ta shoqërojë atë në Shtetet e Bashkuara do të duhet të dorëzojë kopjet e skanuara dhe çdo përkthim të kërkuar të dokumenteve origjinale ose kopjeve të vërtetuara të dokumenteve të listuara nga një zyrë, autoritet ose subjekt lëshues i duhur në vendin e origjinës.

### BULETINI I VIZAVE

Ky buletin përmbledh disponueshmërinë e numrave të emigrantëve gjatë muajit shkurt për: "Datat e Veprimit Përfundimtar" dhe "Datat për paraqitjen e aplikacioneve", duke treguar se kur duhet të njoftohen aplikantët e vizave për emigrantët dhe të mbledhur dhe dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në Qendrën Kombëtare të Vizave. "Zyrtarët konsullorë janë të detyruar të raportojnë në Departamentin e Shtetit për aplikantët e kualifikuar të dokumentuar për viza me numër të kufizuar; USCIS raporton aplikantët për rregullimin e statusit. Data e fundit e veprimit për një kategori të tejkualuar është data prioritare e aplikuesit të parë që nuk mund të arrihet brenda kufijve numerikë. Nëse bëhet e nevojshme gjatë procesit të shpërndarjes mujore për të rikthyer një datë përfundimi të veprimit, kërkesat plotësuese për numrat do

"Udhëzimet dhe dokumentacioni që duhet të plotësoni. Informacionet mbi procedurën"

# Lotaria amerikane, ambasada: Fituesit e 2019-ës të kontrollojnë 'email'-in

"Kur do të njoftoheni për intervistën me konsullin"



### VIZAT

Ky buletin përmbledh disponueshmërinë e numrave të emigrantëve gjatë muajit shkurt për: "Datat e Veprimit Përfundimtar" dhe "Datat për paraqitjen e aplikacioneve", duke treguar se kur duhet të njoftohen aplikantët e vizave për emigrantët për të mbledhur dhe dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në Qendrën Kombëtare të Vizave. "Zyrtarët konsullorë janë të detyruar të raportojnë në Departamentin e Shtetit për aplikantët e kualifikuar të dokumentuar për viza me numër të kufizuar; USCIS raporton aplikantët për rregullimin e statusit.

të ndërrohen vetëm nëse data e përparësisë bie brenda datës së fundit të veprimit të shpallur në këtë buletin. Nëse në çdo kohë do të arrihet një limit vjetor, do të ishte e nevojshme që menjëherë të bëhej kategoria e preferencës "e padisponueshme" dhe nuk do të ndërroheshin kërkesat e mëtejshme për numra", - thuhet në faqen zyrtare të Departamentit Amerikan të Shtetit.

### 'EMAIL'-I

"Ju do t'ju kërkohet të sillni dokumentet origjinale në intervistën tuaj për vizë në ambasaden apo konsullatën e SHBA, së bashku me

përkthimet e kërkuara. KÇ do të dërgojë instruksione që shpjegojnë se si të skanoni dhe dërgoni me 'email' dokumentet dhe përkthimet e kërkuara pasi të keni dorëzuar një aplikim të vlefshëm DS-260 për ju dhe për të gjithë anëtarët e tjerë të familjes. Vizita juaj e intervistës për vizë nuk do të caktohet derisa KÇ të ketë pranuar dhe rishikuar të gjitha dokumentet e nevojshme mbështetëse. Ju do të merrni dokumentet origjinale me vete në intervistën tuaj në një ambasadë ose konsullatë të SHBA. Mos dërgoni asnjë nga këto dokumente në Qendrën Konsullore Kentucky,

pasi do të shkatërrohen", - bën me dije departamenti amerikan i shtetit. Ndërkohë, dokumentet civile dhe personale mund të ndryshojnë nga vendi në vend, varësisht nga disponueshmëria. Mund të ketë udhëzime shtesë për marrjen e dokumenteve civile në një vend të caktuar ose dokumente shtesë të kërkuara, varësisht nga Ambasada e SHBA-ve ose konsullata ku do të aplikohet. Fituesit duhet të zgjedhin ambasaden ose konsullatën ku do të aplikojnë për të mësuar se cilat kërkesa shtesë ekzistojnë, nëse ka.

### INTERVISTA

"Ju duhet të përgatiteni për intervistën tuaj me kujdes. Pamundësia për t'u përgatitur plotësisht për intervistën tuaj në Ambasaden ose Konsullatën e SHBA mund të rezultojë në vonesë ose mohim të aplikimit për vizë. Pasi të keni njoftuar për intervistën tuaj të planifikuar, do t'ju duhet të ndërmerri hapat e rëndësishëm përpara datës së intervistës", - bën me dije Departamenti Amerikan i Shtetit. Fillimisht duhet të shqyrtohet me kujdes informacioni i caktimit në Kontrollin e Statusit të Regjistrimit në faqen e internetit të E-DV, duke shënuar datën, kohën dhe vendndodhjen e intervistës për vizën e emigrantëve. Më tej duhet të merren në shqyrtim Udhëzimet e Intervistës së Ambasadës së SHBA-ve ose konsullatës.

### DERGIMI ME 'E-MAIL'

"Ju do t'ju kërkohet të sillni dokumentet origjinale në intervistën për vizë në ambasaden apo konsullatën e SHBA, së bashku me përkthimet e kërkuara. KÇ do të dërgojë instruksione që shpjegojnë se si të skanoni dhe dërgoni me 'email' dokumentet dhe përkthimet e kërkuara pasi të keni dorëzuar një aplikim të vlefshëm DS-260 për ju dhe për të gjithë anëtarët e tjerë të familjes.

### PERGATITJA

"Ju duhet të përgatiteni për intervistën me kujdes. Pamundësia për t'u përgatitur plotësisht për intervistën në Ambasaden ose Konsullatën e SHBA mund të rezultojë në vonesë ose mohim të aplikimit për vizë. Pasi të keni njoftuar për intervistën të planifikuar, do t'ju duhet të ndërmerri hapat e rëndësishëm përpara datës së intervistës", - bën me dije Departamenti Amerikan i Shtetit.

### UDHËZIMET DHE DOKUMENTACIONI

- Fillimisht duhet të shqyrtohet me kujdes informacioni i caktimit në Kontrollin e Statusit të Regjistrimit në faqen e internetit të E-DV, duke shënuar datën, kohën dhe vendndodhjen e intervistës për vizën e emigrantëve.
- Më tej duhet të merren në shqyrtim udhëzimet e intervistës së Ambasadës së SHBA-ve ose konsullatës.
- Mund të jepen udhëzime shtesë nga Ambasada ose Konsullata e SHBA-ve, ku do të aplikoni dhe intervistoni, prandaj ju lutemi t'i rishikoni me kujdes këto udhëzime.
- Programoni dhe përfundoni një provim mjekësor.
- Ju (dhe çdo anëtar i familjes që aplikoni për vizë me ju) ju kërkohet të planifikoni një takim mjekësor me një mjek të autorizuar në vendin ku do të intervistoheni.
- Shpjegoni se ekzaminimi është për një aplikim për vizë emigrimi dhe jepni mjekun datën e intervistës. Mjeku do t'ju tregojë koston e ekzaminimit dhe testeve.
- Ju lutem vini re se disa nga informacionet e përfshira në këto udhëzime mund të zbatohen për klasifikimin e vizave të emigrantëve përveç vizave të diversitetit.
- Mblidhni fotot dhe të gjitha dokumentet e kërkuara.
- Çdo aplikant i DV do të duhet të sjellë dy (2) fotografi identike në intervistë. Shqyrto informacionin e detajuar rreth kërkesave të fotografive për të siguruar që fotot tuaja do të jenë të pranueshme.

### Dokumentacioni

- Informacioni i takimit të printuar nga Kontrollin e Statusit të Regjistrimit në faqen elektronike të E-DV.
- Fajla e konfirmimit DS-260.
- Pasaportë të vlefshme për gjashtë muaj pas datës së parashikuar për hyrje në SHBA për ju dhe çdo anëtar i familjes që aplikon për vizë.
- Dokumentet origjinale ose kopjet e vërtetuara të dokumenteve civile të dorëzuara në KÇ.
- Sillni një fotokopje të ndonjë dokumenti që nuk i keni dorëzuar KÇ-së si pjesë e procesit të kualifikimit të intervistës.

Ministria e Financave publikon listën me dosjet që ka shqyrtuar nga janari deri në tetor 2018

# Ish-të përndjekurit, 5 mijë trashëgimtarët që marrin paratë

## Dokumentet që duhet të plotësojë çdo përfitues

Trashëgimtarët e ish-të dënuarve politikë, që nuk kanë marrë dëmshpërblimin e kështit të tretë duhet të dorëzojnë dokumentet në Ministrinë e Financave. Janë në total 5 mijë përfitues, dosjet e të cilëve janë shqyrtuar nga Drejtoria e Paguesave nga janari deri në tetor të vitit të shkuar. Burime zyrtare nga ministria bëjnë të ditur se trashëgimtarët njihen si përfitues, por kanë mangësi në dokumentacion. "Gazeta Shqiptare" zbarch sot listën e përfituesve me të gjitha detajet për çdo dosje. Në listën e publikuar shënohet me "V" në rastet kur dokumenti është në rregull, me X kur është gabim dhe është kolona bosh kur dokumenti nuk është paraqitur.

### DOKUMENTET

Të gjithë trashëgimtarët e ish-të dënuarve duhet të sigurohen pranë bankës në të cilën kanë hapur llogarinë që llogaria e tyre është aktive. Në rast se llogaria nuk është aktive, shumica e dëmshpërblimit kthehet mbrapsht në buxhet, duke sjellë vonesa dhe ndërlikime të panevojshme. Kur kemi ndryshim të identitetit, (emër/mbiemër), apo në rastet kur në certifikatë ndryshon emri ose mbiemri, qoftë edhe me një gërmë të vetme në krahasin me dëshminë e trashëgimisë apo prokurës, kartës së identitetit dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm, duhet medoemos që në të gjitha dokumentet, emrat të jenë të njëjtë me atë që është shkruar në certifikatën e lëshuar nga gjendja civile. Në raste se ka transkriptime të gabuara gjatë kohës

nga një certifikatë e një periudhe të caktuar; atëherë këto ndryshime duhet të pasqyrohen brenda formatit të certifikatës, apo edhe të një vërtetimi të veçantë të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Ligji parashikon edhe rastet e ekzekutimeve pa gjyq. "Në rastet e ekzekutimeve kapitale pa gjyq është i domosdoshëm një vendim fakti gjykate që vërteton vdekjen, plus një certifikatë negative e lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Në rastet kur për arsye të njohura në gjendjen civile nuk ekzistojnë dokumente të periudhës përkatëse dhe ky fakt vërtetohet nga gjendja civile, i interesuari është i detyruar të bëjë një gjyq fakti, të cilin edhe në këtë rast si në pikën më lart, duhet ta shoqërojë me një certifikatë negative", thuhet në njoftimin që Ministria e Financave.

EMER	MBIEMER	EMER	MBIEMER	KOPIJE TE LETER NJOFTIMI	NUMER PERSONAL LLOGARI BANKARE	CERTIFIKATE VDEKJE	CERTIFIKATE E TRUNGUT FAMILJAR	DESHMI I TRASHGIMIE	PROKURE	CERTIFIKATE PER CDO NDRYSHIM IDENTITI
Habibe	Hodha			V	V					
Bibë	Hodhaj			V	V					
						V	V	V		
Shpresa	Rruli					V	V	V		
		Engjellushe	Majuni			V	V	V		
		Aziz	Ruli	V	V					
		Miriam	Ruli	V	V					
		Gracela	Ruli	V	V					
Damirane ( Qamir)	Kuçi	Serdho (Ahmet)	Parallangu	V	V	V	V	V		V
		Drita	Kuçi	V	V					
Fatmira (Fatme)	Selenica	Ariana	Borova	X	X	V	V	V		V
		Kanarina	Bashari	V	V					
Kujtina	Kuçi					V	V	V		
		Emira	Rreli	V	V					
		Edvin	Kuçi	V	V					
Luan	Kuçi								P	
Zhaneta	kmakxhin 25.04/1941			V	V					
		Evis	Kuçi	V	V				V	
						V	V	V		
Lumtari	Gjata	Suzana	Bashnifi	V	V	V	V	testament		
		Dorika	Spaho	V	V					
bevkjare (Shëvcur)	Sadkaj			X	X					
Baki	Alëkollli	Luan	Alëkollli	V	V	V	V			
		Hysen	Alëkollli	V	V					
Sali	Alëkollli	Avdulla	Alëkollli	V	V	V	V	ZV		
						V	V	V		
Këze	Shape					V	V	V		
Fatme	Kaba	Luan	Kaba	V	V	V	V	V		
		Gezim	Kaba	V	V					
		Suzana	Celepaja	V	X					
Ninete	Zhupa			V	V					
Qamir	Shape			V	V					
Engjellushe	Zhupa			V	V					
						V	V	V		
Skender	Mane					V	X Lgëv	X		V
Dhimitri (Hamir)	Mane	Sofia (Manica)	Mane	V	V	V	V	fotokopje		V
		Elyon (Gentian)	Mane	V	V					V
		Olgera		V	V					
Robert	Mane			V	V					
Tania	Kolonja			V	V					
Suzana	Mano			V	V					
Vera	Gogofi			V	V					
						V	X Lgëv	V		
Muzes	Mico			V	V					
Tefia	Malsi			V	V					
Hoshi (Bajram)	Mukavelati	Merita	Mukavelati	V	V	V	V	V	PI	
		Admir	Mukavelati	V	V					VI
		Lejla	Lako	V	V					PI
Agim	Samandja			V	V					
Isa	Mukavelati	Anila	Ajazi	V	V	V	X Lgëv	V	P	
		Manjola	Mukavelati	V	V					P
Mahmade	Loca			V	V					
Byntarin	Samandja			V	V					
		Shpresa	Mukavelati	V	V					V
						V	V	V		
Mara	Shkurti					X Lgëv	V	X		
Dile	Gjonaj			V	V					

EMER	MBIEMER	EMER	MBIEMER	KOPIJE TE LETER NJOFTIMI	NUMER PERSONAL LLOGARI BANKARE	CERTIFIKATE VDEKJE	CERTIFIKATE E TRUNGUT FAMILJAR	DESHMI I TRASHGIMIE	PROKURE	CERTIFIKATE PER CDO NDRYSHIM IDENTITI
Gjon	Shkurti			V	V					
Prena	Vladi			V	V					
Lesh	Shkurti					V	V	V		
		Liza	Bunaj	V	V					
		Kastriot	Shkurti	V	V					
		Marte	Lleshaj	V	V					
		Majlinda	Bardhoci	V	V					
		Dritan	Shkurti	X	X					
		Alerdita	Pçaku	X	X					
		Alma	Kryeziu	V	V					
		Ilir	Shkurti	X	X					
Pal	Shkurti					V	V	V		
		Nikolin	Shkurti	V	V					
		Mirzoza	Lajta	V	V					
		Lujeta		X	X					
		Anah	Hoti	X	X					
		Eileva	Ndoj	V	V					
		Arta	Gjini	V	V					
						V	V	V		
Sheqere	Rushaj			V						P
Lajana	Mullarreti			X	X					
Fatmira	Rushaj			V	V					
Bashkim	Rushaj			V	V					V
						V	V	V		
Drande	Sufaj					V	X Lgëv	V		
		Gjyste (Djasta)	Gjonaj (Djonaj)	X					P	X
		Mri	Tanazi	V					P	
		Tereze	Mirashi	X	X					
		Pashke	Cekaj	V	V				P	
		Jak	Isufaj	V					P	
Gjeto	Xhujaj					V	V	V		
		Fran	Xhujaj	V	V					
		Gjyste	Vuku	V	V					
Pjeter	Xhujaj					V	V	V		
		Lulej	Xhujaj	V	V					V
		Zef	Xhujaj	V	V					
		Marje	Dokaj	V						P
		Lene	Kokaj	V						P
		Shaqe	Gjinaj							
						V	V	V		
						V	V	X		
Angjello	Zaho					V	V			
Olga	Comi			V	V					
Spiro	Zaho			V	V					
Elefëria	Dhuka			V	V					
Aristidh	Zaho			V	V					
Stefan	Zaho			V	V					
						V	V	V		
Idajete	Capa					V	V	V		
Hatje	Tifëkciu					V	V	V		
		Masllum	Tifëkciu	V	V					V
		Muft	Tifëkciu	V						P
Kujtina	Tafciu					V	V	V		
Qamir	Capa	Vladimir	Tafciu	V	V					
						V	V	V		
Prene	Gjonaj					V	V	V		
Vlsh	Gjonaj					V	V	V		
		Gasper	Gjonaj	V	V					
		Tone	Pecaj	V	V					
		Anton	Gjonaj	V	V					
		Rozina	Gjonaj	V	V					
		Aleks	Gjonaj	V	V					
		Mikel	Gjonaj			V				
Gjelna	Vata					V	X	X		
						V	V	V		
Nexhie	Hamitaj					V	V	V		







## YLLI MERJA:



Alergjitë në pranverë,  
si t'i kuroni me bimë  
mjekësore

## KESHILLA



10 ushqimet që  
duhet të konsumojnë  
duhanpirësit

# VLERA LEKAJ:



Mjekja e përgjithshme:  
Ja cilët janë faktorët  
që shkaktojnë  
aterosklerozën

## Yndyrat në gjak dhe rreziku që sjellin për zemrën

"Kujdes, mund të  
shkaktojë edhe vdekjen!"

Si t'i përdorni gjethet e dafinës kundër problemeve të tretjes

Mjekja e përgjithshme: Ja cilët janë faktorët që shkaktojnë aterosklerozën

# VLERA LEKAJ: Yndyrat në gjak dhe rreziku që sjellin për zemrën

*"Kujdes, mund të shkaktojë edhe vdekjen!"*

Nga mjekja Vlora Lekaj

Në thelb të sëmundjeve të enëve të gjakut dhe të zemrës qëndron pikërisht një proces, i cili ka në bazë formimin e një lezioni (strukture), i cili ngushton enët e mëdha të gjakut (koronaret), të cilat ushqejnë zemrën me gjak. Ky proces nis që herët dhe shfaqet klinikisht në formën e dhimbjeve të gjoksit të vazhdueshme, infarktit të zemrës, aritmive të ndryshme e deri në vdekjen e papritur. Ky lezion quhet ndryshe lezion aterosklerotik dhe kjo sëmundje e rëndë, që rrezikon jetën njihet si sëmundja aterosklerotike koronare e zemrës (SAK). Prej më shumë se dy dekadash, vdekshmëria nga sëmundjet kardiovaskulare zë vendin e parë në vdekshmërinë e përgjithshme në botë. Në Shqipëri (SAK) vazhdon të jetë një nga problemet më madhore dhe të diskutueshme të shëndetit publik. Lezionet që përmendëm më lartë zhvillohen më së shumti në nivel të arterieve të mëdha dhe tentojnë t'i bllokojnë ato. Procesi nëpër të cilin kalon formimi i këtyre strukturave është një proces kompleks, me bazë inflamacionin, kalcifikimin dhe përfshirjen e shumë lëndëve. Një nga këto lëndë janë pikërisht yndyrat, të cilat luajnë rol kritik në këtë proces, i cili njihet si aterosklerozë, nga ku ka marrë dhe emrin sëmundje aterosklerotike e zemrës.

**YNDYRAT**  
Yndyrat janë lëndë organike, me rëndësi jetësore për organizmat e gjallë. Ato janë pjesë e strukturës së qelizës njerëzore, duke shërbyer si burim energjie për të. Pra, janë të domosdoshme për ciklin e jetës. Sigurisht, momenti kur ato bëhen të rrezikshme ka të bëjë me rritjen e tyre përtej normës. Duke u kthyer kështu në rrezikun më të madh për aterosklerozën, procesin që bllokun dhe demton enët e gjakut duke penguar kështu furnizimin me gjak, i cili bëhet fatal nëse kompromenton punën e zemrës sonë. Duke gërmuar në histori, zbulojmë se kjo problematikë e lidhur me zemrën dhe enët e gjakut që e furnizojnë atë, daton që nga lashtësia. Studiuesit në bashkëpunim me një grup mjekësh kanë arritur të ekzaminonin dhe skanojnë mbetje të mumifikuara të 500 viteve më parë me origjinë egjiptiane. Rezultatet ishin surprizuese, sepse arritën të identifikonin elemente të procesit të



Mjekja e përgjithshme, Vlora Lekaj

aterosklerozës në mostrat e analizuar. Sigurisht, nëse ngremë pyetjen se nga e ka origjinën kjo yndyrë e tepërt, përgjigja do jetë ushqimi. Dhe këtu qëndron e veçanta e studimit sepse vërtetohet se edhe dekada më parë, pavarësisht se ushqimi mund të ketë qenë më natyral, i papërpunuar, përsëri gjejmë elemente të këtij procesi të dëmshëm. Mendohet se baza e ushqimit në lashtësi ka qenë peshku, por dhe peshku përmban disa lloje yndyrash të dëmshme, që kur tejkaloheh norma e tyre, kthehen në të rrezikshme.

**FAKTORË TË TJERË**

Aterosklerozja nuk ka vetëm yndyrat si faktorë të vetëm për ndodhjen e saj. Ndër faktorë të tjerë të rrezikshëm për ndikimin negativ në organizëm dhe rritjen e rrezikut të kësaj sëmundjeje përmendim edhe duhanin. Duhanpirja është një nga faktorët e mënjaneueshëm, pra që njeriu e ka më nën kontroll të vullnetit të tij se faktorët e tjerë. Megjithatë, shëndeti publik rendit pirjen e duhanit si shkakun e vetëm, më të madh të vdekjes së par-

akohshme të individëve të moshës 35 deri 70 vjeç. Siç mund të vihet re, pragu i moshës së vdekjeve të parakohshme është i ulët (35 vjeç). Studiimi më i madh epidemiologjik dokumenton se vdekshmëria kardiovaskulare rritet 18% për meshkujt dhe 31% për femrat për çdo 10 cigare të pira në ditë. Ndërkohë, është vërtetuar që lënia e duhanit te të sëmurët e diagnostikuar me

sëmundje zemre ul rrishtin e vdekjes me 35 deri në 40%. Obeziteti një tjetër faktor i rrezikut për këtë sëmundje, i lidhur sigurisht me treguesin e masës trupore, ku nga studimet treguesit e lartë të masës trupore rrishtin rrishtin e kësaj sëmundjeje 3 herë më shumë se në njerëz me tregues të masës trupore brenda normës. Inaktiviteti fizik, i cili me moshën vjen e pakësohet. Personat


të cilët kanë një aktivitet fizik më të mirë në krahasim me ato që bëjnë një jetë sedentare, janë më pak të prirur për këtë sëmundje. Alkooli, i cili në fakt i konsumuar në doza të vogla mbahet si faktor mbrojtës sepse liron enët e gjakut, por kur kalon sasinë e duhur, bëhet i rrezikshëm për insult cerebral. E theksoj që faktorët e mësipërm hyjnë në grupin e faktorëve të shmangshëm, që mund të ndryshohen nga vullneti dhe forca e njeriut. Të tjerë faktorë deri diku të pakontrolluar nga njeriu janë:

**Gjenetika familjare:** Individët me histori familjare për këtë sëmundje janë më të predispozuar për ta pasur këtë sëmundje. Sigurisht, nëse kësaj prirjeje gjenetike i bashkohet dhe faktorë të tjerë rreziku si duhani apo obeziteti.

**Mosha:** Me kalimin e moshës mbi 45 vjeç, ky rrezik është më i pranishëm më i lartë për meshkujt. Ndërkohë që mbi 70 vjeç, kjo mundësi barazohet për të dyja gjinitë. Nuk mund të lëmë pa përmendur edhe sëmundje si diabeti i sheqerit apo hipertensioni, të cilat në thelb janë të ndikuar nga njëra-tjetra si dhe nga faktorët e tjerë të rrishtit, por mbeten shkaqe të rëndësishme për sëmundjet e zemrës.

**PARANDALIMI**

Parandalimi i kësaj sëmundjeje kërkon investim afatgjatë në shëndet, i cili nis që në fëmijëri, me kujdesin në ushqime të balancuara në yndyra, në mënyrë që për individin të kthehet në kulturë dhe në të ardhmen. Aktivitetet fizike dhe sportive janë një antidot i kësaj sëmundjeje dhe sigurisht edukimi për të mbajtur larg veset si duhani apo alkooli. Kjo është një fazë parandaluese e sëmundjes bazë që të mos shfaqet, por parandalim vazhdon dhe te njerëzit që e kanë këtë sëmundje tashmë, por tani për t'i mbrojtur nga rreziku i vdekjes, ku në këto raste kërkohet ndërhyrja me medikamente dhe regjim të sertë. Ndërgjegjësimi për këtë sëmundje po vjen e rritet në nivel të shoqërisë, por përderësi ka nevojë për thirrje, që të mendolet stili i jetës dhe të kryhen 'check up', ku njerëzit të mund të monitorojnë shëndetin e tyre, sepse niveli i yndyrave vlerësohet në një analizë të thjeshtë gjaku.





Mjeku popullor: Cilat janë simptomat kryesore, produktet që s'duhën konsumuar

Voltiza Duro

# YLLI MERJA:

## Alergjite në pranverë, si t'i kuroni me bimë mjekësore

*"Përdorni trëndafilin e egër dhe lëngun e limonit"*



Ylli Merja

Me ardhjen e stinës së pranverës, vetë moti paraqitet me temperatura të ulëta, me ndryshime e shira, me luhajtje të shpeshta. E gjithë kjo mund të shoqërohet me alergji në shumë persona. Ndërkohë në momentin që temperaturat do të rriten, pemët do të zhveshin sythat e tyre e poleni i luleve do të përhapet në ambient. Kur poleni thithet nga njeriu nëpërmjet rrugëve respiratore të frymëmarrjes, atëherë fillojnë shqetësimet në organizëm. Ky i fundit irritohet e reagon ndaj grimcave, të cilat janë futur në mushkëri e shfaqin problematika, ku numri i leukociteve apo ruazave të bardha të gjakut fillon të rritet e më tej imunoglobulina fillon të marrë viera të larta. Me kalimin e tyre në gjak, fillon të rritet histamina, një kimikat që kur hyn në qarkullimin e gjakut, krijon një iritum, një ënjtje të rrugëve respiratore, një skuqje të syve apo probleme me hundën. Në këto momente, individit i fillojnë teshtimat, ka kruajtje apo nxirre të rrahëve të syve, skuqje të buzëve e në rastet kur këto depozitime janë mbi lëkurë, fillon të irritohet gjithë sistemi. Të gjithë personat janë në kontakt me: polenet, ngacmuesi i parë që shkakton alergji; si dhe myqet që rriten në kushte shtëpie apo në ajër, por theksohet se jo të gjithë njerëzit janë alergjikë e shkaktuara nga dy faktorët e mësipërm. Në rastet kur ulet rezistenca, njeriu është shumë i predispozuar për t'u prekur nga alergjitë e stinës pasi këto elemente e kanë shumë më të thjeshtë që të japin efektin e tyre ngacmues dhe irritues në një organizëm të dobët. Në këtë periudhë njerëzit duhet të jenë të kujdesshëm e të përpiqen të rritin sa më shumë imunitetin.

### SIMPTOMAT

Dallimi i simptomave të alergjisë është i dukshëm e thelbësor, krahasuar me shenjat që shfaqen kur individi është i prekur nga gripi. Nëse personi ka një kollë të

bezdishme, të shoqëruar me rritje të temperaturës e këputje trupore (në këmbë e duar), me një rëndesë në mushkri e dhimbje koke, atëherë duhet kuptuar që këto shenja lidhen me ftohjen. Ndërsa kur njeriu preket nga polenet, ai nuk ka temperaturë, por teshtitje, rrjedhje hundësh, kruajtje sysh e nëse kruhet edhe lëkura, fillon të skuqet.

### TRAJTIMI ME BIMË MJEKËSORE

Normalisht që gjatë kësaj periudhe duhet që individi të kujdeset shumë që të rrisë imunitetin, kështu që duhen përdorur produkte që përmbajnë flavonoide apo vitaminë

C. Nëse u japim fëmijëve 5-6 kokrra trëndafilin të egër, atëherë do të kuptojmë që është një medikament me të vërtetë jo vetëm rifreskues, por që ndikon edhe në rritjen e rezistencës. Gjithashtu, rekomandohet përdorimi i lëngut të limonit e portokallit, si dhe shafraani i kuq. Ndërkaq, këshillohet për të gjithë personat alergjikë, marrja e qumështit të bletës dhe propolisin. Këto dy të fundit janë teshtuor në rastet e personave me alergji kronike e kanë dhënë efekte të mrekullueshme. Qumështi i bletës luan një rol kyç në organizëm, pasi i vë të gjitha organet në punë, duke i bërë më dinamike

Nëse u japim fëmijëve 5-6 kokrra trëndafilin të egër, atëherë do të kuptojmë që është një medikament me të vërtetë jo vetëm rifreskues, por që ndikon edhe në rritjen e rezistencës.

në luftën ndaj virusëve. Një ndër shkaqet e alergjive të stinës janë edhe myqet e këto bëhen shkak për rritjen e shkallëve të iritimit në organizëm. Propolisin antimykotik ul në mënyrën më drestike shkallën e agresivitetit të sporeve të kërpudhave apo poleneve. Rekomandohet të merren 10 pika nga ky medikament në ditë e kështu do të ketë një përmirësim të situatës e qetësim të mushkërive. Edhe çaji antialergjik këshillohet nga ana jonë për pacientët si dhe të bëjnë një shpëlarje të trupit me lëngun e bimëve të trumzës, gjethe e ftoit e mushmollës në mënyrë që të largojmë nga organizmi gjithë pluhurat. Gjithashtu,

është mirë të përdoret një çaj rigoni apo trumze, pak spec i kuq apo djegës që rritin së tepërmi rezistencën e organizmit, pa harruar edhe karotën. Ushqimet si qumështi, djathi, kosi nuk këshillohen që të përdoren nga personat alergjikë pasi janë kultura shumë të përshatshme ku mund të zhvillohen më së miri ngacmuesit që shkaktojnë alergji. Gjithashtu, edhe çaji i kamomilit nuk duhet të përdoret pasi e vë trupin në gjumë dhe ndërkohë fitojnë terren e shumohen mikroorganizmat që shkaktojnë alergji. Në rastet kur individët kanë bllokim të sipërm të rrugëve të frymëmarrjes, pra të hundës, atëherë duhet të përdorin vajin e dafinës, i cili ka efekte të mrekullueshme në luftimin e alergjisë pasi përmban flavonoide që minimizojnë iritimet. Njerëzit që kanë lotim të syve nga alergjia duhet t'i shpëllajnë fillimisht me ujë të ftohtë, ose me çajin e cianës, e pas kësaj të bëjë një lyerje nga jash-të me hudhër, ndërsa në rastet e kollës së thatë duhet të përdoret lulja e thundërmushkës apo propolisit.



# 10 ushqimet që duhet të konsumojnë duhanpirësit

**D**uhanpirja është shkak numër 1 i sëmundjeve të parandalueshme që çojnë drejt vdekjes. Nikotina është kimikati që e bën lënien e duhanit kaq të vështirë, ajo është një ndër kimikatet kundrejt të cilave njeriu krijon më tepër vartësi. Nikotina është një stimulant i cili bllokton qelizat nervore dhe muskulore nga funksionimi normal. Pavarësisht paralajmërimeve që ka bërë shpenca për dëmtimet e duhanit, njerëzit akoma vazhdojnë ta pinë atë. Nëse ju pini duhan, për të nxjerrë nikotinën jashtë organizmit duhet të konsumoni ushqime të caktuara. Ekziston më shumë se një mënyrë për ta bërë këtë me ushqime të ndryshme. Më poshtë do të kuptoni se si funksionojnë dhjetë ushqime në raport me nikotinën.

## 1- Brokoli

Brokoli përmban nivele të larta të vitaminës B, B5, C dhe është përgjegjës për rregullimin e shumë proceseve në trupin tonë. Mungesa e këtyre vitaminave çon organizmin tonë në keqfunksionim.

## 2- Portokalli

Portokalli është një frut i fuqishëm, nxjerr nikotinën nga



organizmi dhe shton nivelet e vitaminës C. Portokalli redukton stresin dhe ankthin që shkakton dëshira për të pirë duhan.

## 3- Spinaqi

Spinaqi përmban acid folik dhe vitaminë B9, të cilat janë të njohura për zhvendosjen e nikotinës nga trupi. Nikotina mund të ndërpresë gjumin normal dhe duhanpirësit mund të vuajnë nga çrregullime në gjumë. Acidi folik lufton simptomat e varësisë nga nikotina si dhe ndikon në mirëqenien mendore dhe emocionale.

## 4- Xhinxheri

Xhinxheri mund të ndihmojë që të çlirohemi nga simptomat e padëshiruara të duhanit dhe nikotinës. Për efekt të plotë duhet të



konsumoni xhinxher para se të ndjeni dëshirën për nikotinë, kështu mund të humbni peshë në mënyrë të shëndetshme si dhe të elimini toksinat nga qarkullimi i gjakut. Mënyra më e mirë për të lënë nikotinën është të lini duhanin dhe të lini që xhinxheri të japë

efektet e tija.

## 5- Boronica e kuqe

Acidi në boronicën e kuqe ndikon që nikotina të zhvendoset nga organizmi më shpejt se zakonisht. Nikotina ngre nivelin e sheqerit në gjak, ashtu siç veprojnë boronicat e kuqe pra

është bazike kur përpiqemi të lëmë duhanin.

## 6- Limoni

Limonët janë një tjetër armë për të shkatërruar nikotinën e organizmit. Nëse pini duhan, nikotina qëndron në organizëm për tri ditë. Dëmton lëkurën e qelizave dhe poret, por konsumimi i limonit dhe i vitaminës C forcon shëndetin e lëkurës dhe zbeh simptomat e padëshirueshme të nikotinës.

## 7- Karota

Ajo që i shkaktohet një duhanpirësi të rregullt është pakësimi i vitaminës A dhe C. Konsumimi i karotës do të plotësojë nevojat tuaja për vitaminë K, A dhe C duke forcuar sistemin imunitar.

## 8- Shega

Pirja e duhanit rit rrahjet e zemrës, presionin e gjakut dhe ul nivelin e oksigjenit në gjak. Shega lufton këto simptoma dhe ndihmon në prodhimin e qelizave të kuqe të gjakut.

## 9- Gruri

Pirja e duhanit mund të ngushtojë enët e gjakut, por nëse përpiqeni të hani nga bima e grurit që rrit në ara, atëherë kjo mund të ndihmojë për të përmirësuar elasticitetin e sistemit të qarkullimit të gjakut. Duke konsumuar grurë, mund të zvogëlojmë rrezikun e zhvillimit të sëmundjeve të zemrës kur ju të plakemi.

## 10- Lakër jeshile

Lakra jeshile është e njohur si një perime që ju mbron nga kanceri. Ajo është një antioksidant, pra ju ndihmon që të largoni nga trupi lëndë të panevojshme përfshirë nikotinën.



# Këshilla



## 7 faktorët që shkaktojnë dhimbje koke në mëngjes

**Z**gimi në mëngjes me dhimbje koke është mënyra më e keqe për të nisur ditën. Dhimbjet e kokës në mëngjes shpesh tingëllojnë të pakuptimta, për vetë faktin se trupi supozohet të ketë pushuar gjatë natës.

### GJUME I PAMJAFTUESHEM

Trupi ka nevojë për shtatë deri në tetë orë gjumë që të funksionojë siç duhet. Nëse flini më pak, atëherë ka diçka që nuk shkon dhe organizmin e kap paniku. Hormonet arrijnë kulmin, bashkë me rrahjet e zemrës, tensionin e gjakut dhe stresin thonë ekspertët e sëmundjeve neurologjike. Një zgjidhje e shpejtë për këtë problem janë disa medikamente kundër dhimbjeve që funksionojnë menjëherë. Nëse mundeni përpikni të dremisni për 20-30 minuta që t'i jepni mundësi trupit të funksionojë më mirë.

### GJUME I TEPRUAR

Nëse flini më shumë se nëntë orë, atëherë bie niveli i serotoninës, një hormon i çliruar nga truri. Sa më të ulëta të jenë nivelet e serotoninës, aq më pak gjak

qarkullon në tru, gjë që nxit dhimbjen e kokës.

### LUHATJET HORMONALE

Në mëngjes, nivelet e endorfinës, hormonit të humorit të mirë janë të ulëta. Një gjë e tillë mund të shkaktojë migrenë tek disa njerëz.

Sipas të dhënave të "AgroWeb.org", mungesa e hormoneve vështirëson qarkullimin e gjakut në tru dhe rrjedhimisht koka dhemb. Aktiviteti fizik në mëngjes nxit prodhimin e hormoneve dhe mund të pushojë dhimbjen e kokës.

### PASOJAT E ALKOOLIT

Nëse një natë më parë e keni tepruar me alkoolin, atëherë përgatituni për dhimbje koke mëngjesin e të nesërme. Pirja e alkoolit shkakton dehidratim dhe pakësim të qarkullimit të gjakut në tru. Mënyra më e mirë është që të hidratoheni me ujë ose pije të pasura me elektrolite. Vitamina C e tretur në ujë ndihmon mëllçinë të përpunojë alkoolin, në mënyrë më efikase dhe ta nxjerrë atë nga sistemi sa më parë.

### GËRHITJA

Gërhitja, mungesa e ajrit, marrja e frymës pakësojnë

sasini e oksigjenit në tru dhe prishin cilësinë e gjumit. Mungesa e oksigjenit zgjeron enët e gjakut dhe qarkullimin e tij në tru. Presioni është i lartë dhe koka dhemb.

### MUNGESA E KAFESË

Kafeina luan rol stimulus për sistemin nervor. Nëse jeni mësuar duke e pirë kafënë në një orë të caktuar dhe nuk i përbaheni rutinës, do të ndieni dhembje të fortë të kokës. Heqja dorë nga kafeja ka të njëjtin efekt dhe rrit presionin në tru, duke shkakuar dhimbje koke.

### DEPRESIONI

Dhimbjet e kokës mund të ndodhin edhe si pasojë e depresionit. Ky i fundit ka lidhje të fortë me nivelet e ulëta të serotoninës. Studimet që disponon "Agroweb.org" tregojnë se depresioni prish gjumin dhe dhimbja e kokës prish humorin, duke krijuar kështu një rreth vicioz të pakapërcyeshëm.

### TENSIONI I LARTË

Nëse vuani nga tensioni i lartë i gjakut, atëherë dhimbjet e kokës janë më frekvente. Tensioni i lartë i gjakut është një sëmundje që kurohet nëpërmjet ndryshimeve thelbësore në regjimin ushqimor dhe medikamenteve përkatëse.



## Si t'i përdorni gjethet e dafinës kundër problemeve të tretjes

**G**jethet e dafinës janë të pasura me përberës bimorë, vitamina dhe minerale plot vlera. Ato ndihmojnë tretjen dhe shmangin çrregullimet në këtë sistem. Nëse pini çaj dafine, mund të luftoni aciditetin e lartë në stomak dhe të zgjidhni problemin e lëvizjeve të çrregullta të zorrëve. Gjethet e dafinës përmbajnë enzima që mundësojnë shpërbërjen e proteineve dhe rrjedhimisht ato janë një zgjidhje e shkëlqyer. Merrni 5 gramë me gjethë dafine, shtoni një centimetër xhenxhefil dhe ziejini së bashku në 300 ml ujë deri sa të mbetet ¼ e ujit. Shtoni mjaltë dhe piheni lëngun dy herë në ditë derisa të rregulloni organizmin. Ata që vuajnë nga problemet e zembrës dhe ankthi duhet të ziejnë tri gramë me gjethë dafine dhe 3-4 gramë me lule të trëndafilit të egër në 300 ml ujë. Lëngu duhet të ziejë deri sa të mbetet 75 ml e ujit. Kullojeni dhe piheni për 4 javë. Gjethet e dafinës janë efikase kundër infeksioneve dhe simptomave të të ftohtit dhe gripit. Në rastet kur vuani nga probleme me frymëmarrjen, zieni disa gjethë dafine në ujë. Lëreni të ftohet për 10 minuta. Zhysni një napë në lëng dhe më pas vendoseni në kraharor për ta çliruar nga bllokimet e shkaktuara nga i ftohti, kolla dhe virozat. Nëse vuani nga tështimat e përsëritura, zieni disa gjethë dafine në 200 ml ujë deri sa të mbetet ¼ e tij. Kullojeni dhe piheni lëngun. Nëse konsumoni gjethë dafine nëpërmjet çajit, përpara fjetjes do të keni një gjumë të mirë dhe të qetë. Ky çaj bën mrekulli. Gjethet e dafinës ndihmojnë kundër infeksioneve dhe gurëve në veshka. Zieni 5 gramë me gjethë dafine në 200 ml ujë deri sa të mbetet 50 ml e tij. Kullojeni dhe lëngun piheni dy herë në ditë. Ky lëng do të parandalojë edhe formimin e gurëve.

## Draft për marrëveshjen Kosovë-Serbi? Dokumenti është gati

### Media kosovare: Parashikohet shkëmbim terrioresh i hartuar nga ekspertët amerikanë, rusë e francezë

Mediat në Preshevë bëjnë dyshime se një draftmarrëveshje përfundimtare mes Kosovës dhe Serbisë është gati. Dokumenti sipas tyre parashikon shkëmbimin e terrioreve mes dy vendeve dhe është hartuar me ndihmën e ekspertëve amerikanë, rusë dhe francezë. Marrëveshja i kalon pjesën më të madhe të veriut të Kosovës, Serbisë. Në territorin e Kosovës hyjnë Presheva dhe Med-

vegja. Mitrovica bashkohet, do të ketë statusin veçantë të "qytetit të lirë" dhe do të administrohet nga dy drejtues një shqiptarë dhe një serb dhe do të ketë një asamble me 50 anëtarë. Të njëjtin status të "qytetit të lirë" do të ketë edhe Bujanovci. Qytetet do të mbikëqyren nga Kombet e Bashkuara, ndërsa banorët do të mbajnë dokumente të

Bashkimit Europian dhe disa të tjerë, dytësorë të Kosovës ose Serbisë, që i përzgjedhin sipas dëshirës. Këtë status, qytetet do ta mbajnë deri 99 vjet me të drejtë rinegocimi. Liqeni i Ujmanit do të shndërrohet në pronë të përbashkët mes qeverive të Prishtinës dhe Beogradit dhe i jepet me koncesion një konsorciumi britaniko-gjerman.

Ndërsa kompleksi industrial i Trepcës do të administrohet nga amerikanët, rusët dhe francezët. Kosovës i shkojnë 50% e fitimeve, ndërsa Serbisë 35%, pjesa tjetër Mitrovicës. Kishat ortodokse të Pejës, Deçanit, Prizrenit dhe Graçanicës konsiderohen terriore serbe. Marrëveshja përmban në total 22 pika dhe sipas mediave në Preshevë



duhet të arrihet deri në qershor. Në këmbim, Serbia përfiton 3.5 miliardë euro

investime nga një plan Marshall, ndërsa Kosova 1.2 miliardë.

Ministri i Jashtëm gjerman: Jemi të vendosur për t'i ndihmuar kosovarët

# Gjermania, mesazh të fortë Kosovës: Duhet të besoni te ne

## Luhatje në koalicionin qeverisës në Prishtinë

Jemi të vendosur ta ndihmojmë Kosovën dhe këtë ua kemi thënë kolegëve kosovarë javën e kaluar, se ata duhet të besojnë fort në mbështetjen e Gjermanisë". Kështu ka thënë ministri i Jashtëm i Gjermanisë, Heiko Mas për gazetën gjermane "Stuttgarter Nachrichten". "Duan perspektivë evropiane për Kosovën, ndërsa reformat, të cilat janë kryer atje, janë mbresëlënëse dhe duhet të pranohen", ka thënë Mas, i cili ka konfirmuar mbështetjen e mëtejshme financiare të Gjermanisë për Kosovën. Gazetës gjermane "Stuttgarter Nachrichten", ministri i Jashtëm gjerman, Heiko Mas, i ka thënë se, "qeveria gjermane e konsideron të gabueshme nëse BE-ja dhe Gjermania heqin dorë nga mbështetja për Kosovën, përfshirë këtu edhe ndihmën financiare. "Po të ndodhë kjo, për një kohë të shkurtër do të shembet e gjitha ajo që është arritur me mund të madh për një kohë të gjatë". Në artikullin e gazetës Franz Feyder, Christoph Reisinger të botuar në gazetën gjermane "Stuttgarter Nachrichten" kushtuar Kosovës, citohet ministrin e Jashtëm, Heiko Mas, që të ketë thënë se, "reformat të cilat janë kryer atje janë mbresëlënëse dhe ato duhet të pranohen". Edhe pse kanë kaluar 20 vite pas përfundimit të luftës, në të cilën ishte e angazhuar NATO dhe partnerët e saj në Kosovë, Mas konfirmon edhe më tej vazhdimin e ndihmës financiare të Gjermanisë për këtë vend. I pyetur nga "Stuttgarter Nachrichten", lidhur me këtë çështje, ministri i Jashtëm gjerman, Mas, ka thënë se: "Duan perspektivë evropiane për Ballkanin Perëndimor dhe për Kosovën. Reformat të cilat janë kryer atje, janë mbresëlënëse dhe ato duhet të pranohen", ka thënë ai. Mas ka thënë gjithashtu se e konsideron të gabueshme nëse BE-ja dhe Gjermania heqin dorë nga mbështetja për Kosovën,



përfshirë këtu edhe ndihmën financiare. "Po të ndodhë kjo, për një kohë të shkurtër do të shembet e gjithë ajo që është arritur me një mund të madh për një kohë të gjatë", ka theksuar Mas teksa ka shtuar se, "Gjermania është e vendosur të ndihmojë Kosovën dhe këtë ua kemi thënë kolegëve kosovarë javën e kaluar, se ata duhet të besojnë fort në mbështetjen tonë". "Qeveria gjermane shkruan "Stuttgarter Nachrichten" nga viti 2014 deri në vetin 2018, ka mbështetur Kosovën me gjithsej 179,33 milionë euro. Paratë kanë shkuar për zhvillimin e infrastrukturës, ekonomisë dhe reformave në administratë dhe gjyqësi, por edhe për të ndihmuar në luftimin e krimin dhe organizuar në krimin të organizuar. Përveç kësaj ndihme direkte financiare nga Gjermania, Kosova ka marrë brenda pe-

riudhës 2014-2017 më shumë se 350 milionë euro nga Bashkimi Evropian". Ndërkaq, për periudhën njëvjeçare 2018-2019, Bashkimi Evropian ka parashikuar një ndihmë financiare prej 295,3 milionë euro për Kosovën. Sipas artikullit të gazetës gjermane "Stuttgarter Nachrichten", injeksioni financiar nga Bashkimi Evropian për Kosovën përbën pothuaj një të tretën e buxhetit shtetëror të Kosovës. Ndërkaq, nga ana tjetër, brenda koalicionit qeverisës lidhur me taksën ndaj prodhimeve serbe janë krijuar dy qëndrime, gjë që ka bërë që të ketë luhatje ndërmjet partive në pushtet, ndonëse asnjëra nga to zyrtarisht nuk pranojnë se koalicioni është i paqëndrueshëm. Është kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, që me gjithë presionin ndërkombëtar, veçantë-

isht atij të SHBA-ve për heqjen e taksës ndaj Serbisë, thotë se taksat nuk do të hiqet deri në njohjen e Kosovës nga Serbia. Haradinaj shprehet se edhe brenda koalicionit i kanë "pikëpamjet se si mund të ecin proceset me mirë lidhur me taksën", por shton se, "vendimi për taksën do të respektohet, sepse është vendim i qeverisë". "Ne kemi një vendim dhe derisa ekziston vendimi, këto janë mendime tona të ndërsjella, mund të diskutojmë, mund të vazhdojmë me diskutime, por vendimi respektohet, sepse është vendim i qeverisë. Edhe ne kemi dëshirë ta heqin taksën, e kishim bërë që nesër sikur të na kishte njohur Serbia. Tani është mirë të kalojmë në fazën finale të dialogut dhe të ndodhë njohja, sepse është në të mirën e të gjithëve në rajon. Por nuk nuk bën të na vendosin kushte dhe nuk parashihet të shkojmë në dialog me me kushte", thotë Ramush Haradinaj. Partneri i madh i koalicionit qeverisës, Partia Demokratike e Kosovës, (PDK), së fundi ka propozuar që taksat ndaj prodhimeve të Serbisë të pezullohet për 120 ditë, në mënyrë që t'i hapet rruga dialogut duke pritur edhe reflektimin e Serbisë. Këtë po e kërkon edhe SHBA. Në të kundërtën sipas PDK-së, nëse Serbia nuk reflekton, kjo taksë mund të rivendoset shpejt. "Dje një vendim po i prish marrëdhëniet e Kosovës me Shtetet e Bashkuara", ka thënë ministri i PDK-së në qeveri, Abelard Tahiri. Në këtë situatë, ku dy partnerët kryesorë të koalicionit kanë qëndrime të

ndryshme rreth vendimeve qeveritare, në mediat e Prishtinës ka nisur debati për "qëndrueshmërinë" e këtij koalicioni dhe mundësinë e krijimit të një qeverie me bazë të gjerë, ku do të përfshihej edhe partia më e madhe opozitare LDK, e cila po ashtu ka rezervat e saj, sa i përket vendosjes së taksës ndaj prodhimeve të Serbisë pa një analizë të mirëfilltë, ku kërkon që të respektohen edhe kështillat e miqve të Kosovës, sidomos atyre të SHBA-ve. Madje, është vetë kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, i cili ka thënë se, "nëse nuk mund të ketë zgjedhje të jashtëzakonshme, atëherë mund të ketë opsion të dytë, reformim të institucioneve dhe udhëheqësi në bazë të fuqisë politike në parlament. Njëra nga deputetet e LDK-së, Vjosa Osmani, thotë se zgjedhjet e reja do të ishin opsioni më i mirë. "Në kohën kur kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, ka përmendur idenë për qeveri gjithëpërfshirëse, e ka pasur vetëm si një alternativë nëse nuk ka zgjedhje. Por, në si LDK akoma vazhdojmë të insistojmë se zgjedhja e vetme, e cila na nxjerr nga ky qorrsoak në aspektin e krizës institucionale janë zgjedhjet që do të prodhonin një qeveri të fuqishme, jo vetëm në numra, por edhe në aspektin legjitimitetit demokratik, e cila përfaqëson Kosovën në Bruksel", është shprehur Vjosa Osmani. Ajo thotë se qeveria gjithëpërfshirëse nënkupton një qeveri, ku do të përfshiheshin të gjitha partitë dhe ku do të ketë një afat kalimtar vetëm për të përfunduar çështjen e dialogut.



## Shuhen në aksident babai me dy djemtë

Një aksident rrugor i ndodhur mbrëmjen e së shtunës në Kosovë u ka marrë jetën 3 anëtarëve të një familjeje. Sipas mediave kosovare, aksidenti ka ndodhur në fshatin Zhur të Prizrenit, ku për pasojë kanë gjetur vdekjen Rami Sope, 50 vjeç dhe dy djemtë e tij Behar e Lumbardh Sope, përkatësisht 24 dhe 22 vjeç. Për shkak të aksidentit të rëndë, autoritetet kosovare e kanë shpallur të dielën ditë zie. Ndërkohë, pas ngjarjes, Policia e Kosovës ka marrë masa shtesë për kontrollin e shpejtësisë në autostradë. Aksidenti ndodhi kur mjeti me të cilin udhëtonin 3 familjarët, tip "Golf", u përplas me një kamion që po pastronte borën. Shkak për përplasjen dyshohet të jenë bërë ngricat, që e kishin bërë aksin rrugor në nënkallimin e autostradës të rrëzëqitshëm.

**Probleme me Brexit, frikë për trazira në Britani**

**Ulje ekonomike? Sondazhi: Një e treta e bizneseve mund të largohen jashtë vendit**

Ka shenja në rritje se pasiguria lidhur me daljen e Britanisë nga Bashkimi Evropian po fillon të ndjehet tek investimet. Një sinjal i tillë ishte njoftimi i prodhuesit japonez të makinave, "Nissan" për largimin nga Britania. Korrespondenti "Zërit të Amerikës", Henry Ridgwell njofton nga Londra se sipas një sondazhi të kohëve të fundit, një e treta e bizneseve britanike mund të largohen jashtë vendit si rezultat i Brexit. Ndërkohë, në media kanë rrjedhur edhe planet sekrete të qeverisë për rastet emergjente që parashikojnë evakuimin e mbretëreshës nga Pallati Buckingham, në rast trazirash nëse Britania largohet nga BE-ja pa ndonjë marrëveshje. Për dekada me radhë, firmat japoneze e kanë përdorur Britaninë si portën drejt Evropës. Por, vendimi i kompanisë "Nissan" për të zhvendosur në



Japoni prodhimin e modelit të makinës "X-Trail" ka shkaktuar ankth. Ministri britanik i Biznesit, Greg Clark shpjegon: "Shqetësohem, sepse ata kanë vërejtur pasigurinë që lidhet me Brexit dhe mendoj se është sinjal serioz për të gjithë në parlament, se ka ardhur

koha të zgjidhim këtë pasiguri". Ndërsa lidhjet e Britanisë dobësohen, Japonia dhe BE po festojnë nënshkrimin e një marrëveshjeje tregtare, që do të përfshijë një të tretën e prodhimit global bruto. Gjatë vizitës në Tokio të hënën, kancelarja Angela Merkel tha se një marrëveshje për Brexit-in ende ishte e mundur: "Duhet ta dimë nga Britania se cilat janë planet e tyre për të ardhmen, kjo është pika kritike". Me kalimin e ditëve, rreziku po shtohet edhe më shumë për mosarritjen e një marrëveshjeje për Brexit-in. Planet për raste emergjente të qeverisë të rrjedhura në media sugjerojnë evakuimin e familjes mbretërore, nëse ka trazira. Ndër skenarët më të rrezikshëm janë edhe trazirat në rrugë si rezultat i mungesës së ushqimit dhe ilaçeve, ndër-

sa kufizimet e eksportit të plehrave krijojnë male me mbeturina. Alberto Alemanno është profesor i drejtësisë në shkollën ndërkombëtare të biznesit "HEC Paris", i cili shpreh: "Duket që është një skenar shumë i komplikuar, që sjell ndërlikime për qytetarët, për bizneset në të dyja anët e Kanalit të La Manshit. Por varianti tjetër është rishqyrtimi i marrëveshjes së tërheqjes... Jo tërësisht, vetëm pjesëtarja e procesit që mund të çojë në miratimin e planit nga parlamenti". Kjo mund të mos mjaftojë. Britania po kërkon ndryshime në të ashtuquajturën "ndaesa irlandeze", e cila kërkon të mbajë Britaninë të lidhur me rregullat e BE deri në arritjen e një marrëveshjeje tregtare, që synon të mënjanojë pengesat kufitare mes Irlandës dhe

Irlandës së Veriut, ku do të jetë kufiri i tokësor i Bashkimit Evropian me Britaninë. Profeshori për politikën evropiane, Anan Menon, sqaron: "Ata nuk do na ofrojnë ndihmë për mbajtjen në fuqi të rregullave ekzistuese të lëvizjes në kufirin irlandez për një kohë të kufizuar". Rihapja e marrëveshjes së largimit mund të bëjë që edhe vende të tjera të BE-së të kërkojnë ndryshime, kryesisht kërkesat e Spanjës për bisedime mbi sovranitetin e Gjibraltarit, thotë profesori Alberto Alemanno. "Mund të kemi kërkesa nga disa shtete anëtare dhe Spanja mund të jetë njëra prej tyre. Po ndryshon edhe faktori politik në Evropë, madje shumë shpejt, para zgjedhjeve të bllokut në muajin maj". Një kutjesë se ngërçi aktual është vetëm fillimi i rishikimit të marrëdhënieve të Britanisë me një Evropë në ndryshim, një proces që mund të marrë vite, ose ndoshta dekada.

**SHKURT**  
**Mbi 130 viktima nga alkooli**

Të paktën 130 persona humbën jetën dhe mbi 200 të tjerë po trajtohen në spitale, si pasojë intoksikimit nga alkooli në Indi. Sipas autoriteteve vendëse, bilanci i viktimitave pritet të rritet më tej. Shkaku i tragjedisë ishte konsumi i alkoolit të paligjshëm, të bërë në mënyrë artizanale nga shtetësit lokalë. Lënda toksike ushqaktoi konsumatorëve të vjella, dhimbje të fortë në gjoks dhe probleme me frymëmarrjen. Alkooli artizanal është një prej vrasësve më të mëdhenj në Indi.

**Flet avokati i Maria Butinas**

Avokati i Maria Butinas, shtetases ruse të akuzuar nga prokuroria amerikane për lobizëm të paligjshëm të huaj, thotë se pasaporta e saj u është dorëzuar autoriteteve amerikane të emigracionit për të mundësuar deportimin e saj të pritsëm drejt Rusisë. Në një intervistë me agjencinë shtetërore ruse të lajmeve "TASS", avokati Robert Driscoll tha se shpreson që gjykata amerikane do të shpallë vendimin për dënimin e saj brenda 2-6 javësh pas seancës dëgjimore të caktuar për të më datën 26 shkurt. Zoti Driscoll citohe t'u ketë thënë gazetarëve rusë se, "shpresojmë që ajo do të dënohet me periudhën e mbajtjes deri më tani në burg dhe se do të lirohet dhe deportohet menjëherë". Edhe nëse zonja Butina merr një dënim të barabartë me periudhën gjatë së cilës është mbajtur në paraburgim, duke mundësuar kështu edhe lirinë e saj, avokati Driscoll tha se atij sërish do t'i duhet të negociojë me zyrtarët e Agjencisë për Emigracionin dhe Doganat të Shteteve të Bashkuara për të mundësuar deportimin e një të dënuarë për krime federale. Sipas dokumentit të pranimit të fajësisë të nënshkruar nga zonja Butina për prokurorinë amerikane, zyrtarëve amerikanë u rezervohet e drejta ta mbajnë atë nën arrest deri në përmbytjen e bashkëpunimit të saj. Zonja Butina pranoi fajësinë në muajin dhjetor për konspiracion në luajtjen e rolit të një agjenteje të pargjestrutuar të Rusisë dhe u mbajt në izolim për disa muaj. Sipas avokatit të saj, pas pranimit të fajësisë, ajo u transferua në një qeli të sigurisë së ulët dhe i është lejuar të përdorë palestrenë, të ushqehet së bashku me të burgosurat e tjera, të hyjë në familinë e burgut si dhe të shikojë programe televizive deri në dy herë në javë.

**Përgjaken rrugët/ 2 të vdekur e 285 të plagosur, Mike Pompeo dënon dhunën**

**Venezuela në kaos, protestuesit përleshën për ndihmat në kufi**

**Ushtria mat forcat me grupet anti-Maduro**

Ditën e djeshme ushtria venezueliane u përgjigj me gaz lotsjellës e plumba gome rrepe të protestuesve anti-Maduro, që përpqeshin të fushin kamionët me ndihma amerikane nga Kolumbia. Sipas organizatave për të drejtat e njeriut, ushtria venezueliane përdori edhe armët kundër civilëve, duke shkaktuar më shumë se 2 viktima. 285 është bilanci zyrtar i të plagosurve. Shumë prej kamionëve me ndihma u dogjën. Përplasje pati edhe në kufirin me Brazilin. 64 ushtarë venezuelianë u bashkuan me protestuesit. Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, dënoi dhunën e ushtrisë ndaj civilëve të paarmatosur, teksa paralajmëroi pasojë për regjimin dhe ata që shkelin demokracinë. Me manifestuesit u bashkua edhe lideri opozitar pro-perëndimor, Huan Guaido. Ndërsa majtisti Nikolas Maduro mori pjesë në një manifestim me ritme latine në Karakas në mbrojtje të revolucionit. Ndërkaq, konflikti për furnizimin me ndihma humanitare të Venezuelës po ashpërsohet. Mijëra vullnetarë duan të sjellin ndihmat në vend. Kreu i opozitës, Juan Guaido, bëri të ditur se ndihmat e para ndërkohë kanë hyrë në vend. Sipas presidentit të vetëshpallur, Juan Guaido, ka hyrë ndërkohë në Venezuelë furnizimi i parë me ndihma humanitare jashtë. Një furnizim ka ardhur nga Brazili në Venezuelë, bëri të ditur Guaido të shtunën në mbrëmje në "Twitter". "Ky është sukses i madh. Venezuela", shkroi Guaido, i njohur ndërkohë si president nga më shumë se 50 shtete. Shumica e ndihmave humanitare qëndrojnë në kufi me Kolumbinë, në qytetin Cucuta. Aty ndodhen edhe rreth 600 tonë ush-



qime dhe ilaçe nga SHBA. Mijëra vullnetarë dhe përkrahës të presidentit të vetëshpallur, Juan Guaido, kanë shkuar të marrin ndihmat humanitare. Kreu i opozitës, Juan Guaido kishte njoftuar më parë, se do të merrte ndihmat humanitare brenda vendit bashkë me vullnetarët. Për shkak se presidenti Maduro ka mbyllur kufirin me Kolumbinë dhe Brazilin, vëzhguesit i tremben një gjakderdhjeje të madhe, nëse ushtarët do të përpigjen të ndalin njerëzit me dhunë. SHBA paralajmëron Maduron Në Urena, një zonë kufitare me Kolumbinë ka pasur trazira. Ushtria venezueliane ka për-

dorur ndërkohë gazin lotsjellës dhe plumba gome për të shpërndarë një demonstratë në kufi. "Ne duam të punojmë" dëgjohej thirrjet e masës së mbledhur përballë Gardës Kombëtare. Dy civilë ndërruan jetë, sipas një deputeti venezuelian, kur në San Francisco de Yuruani domin të sillnin ndihmat brenda kufirit, dhe aty u qëlluan nga ushtarët. Dëshmitarët njoftojnë se kanë parë tanke nga ana venezueliane që kanë shkatërruar barrierat e vëna, me të cilat bllokohet ura Si-

mon Bolivar, që lidh Venezuelën me Kolumbinë. Qeveria amerikane ndërkohë ka paralajmëruar presidentin Maduro nga përdorimi i dhunës. "Bota po shikon", thuhet në deklaratën e Shtëpisë së Bardhë të publikuar të premtën. Pas njoftimit për humbjen e jetës së dy civilëve, këshilltari i presidentit amerikan për sigurinë, John Bolton shkroi në "Twitter" se autorët do të dalin para drejtësisë. "Ushtria është për të mbrojtur civilët e jo për të qëlluar mbi ta".

**BALLKAN, DËME NË URA DHE RRUGË KOMBËTARE NGA STUHITË**

Këto janë pasojat e stuhive të fuqishme që goditën Bosnje Hercegovinën dhe të gjithë Ballkanin fundjavë. Erërat e forta shembën edhe konstruktionet e betonit dhe hekurit në qytetin jugor boshnjak të Trebinjës. Ato arritën një shpejtësi prej mbi 160 km/orë. E njëjta situatë e rëndë edhe përgjatë bregdetit kroat. Disa kamionë u përmbysnë në rrugët e Splitit, ndërsa banorë u gjendën në vështrësi mes erërave të forta.



**FOTOLAJM**

Dje në Radio Evropa e Lirë

# Marrëveshja Kosovë-Serbi, në funksion të stabilitetit në rajon

Nga Artan Konushevci

(vijon nga faqja 1)

...si e domosdoshme për të parandaluar destabilizimin e rajonit. Gjendja në rajon konsiderohet fraxhile, andaj edhe janë shpeshtuar thirrjet edhe nga komuniteti ndërkombëtar që Kosova dhe Serbia të zgjidhin çështjet e pazgjidhura përmes një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse dhe obligative për të dyja palët. Presidenti Hashim Thaçi gjatë kësaj jave tha se në 12 muajt e fundit, në raportet mes Kosovës dhe Serbisë ka vetëm regres. "Nuk kam kurrfarë dyshimi që nëse këtë vit nuk do të bëjmë marrëveshje ligjërishit detyruese mes të Kosovës dhe Serbisë, do të hyjmë në një zonë të rrezikshme të këtyre raporteve, që mund ta destabilizojnë gjithë rajonin", deklaroi Thaçi. Nga ana tjetër, edhe politikanët nga partitë politike opozitare konsiderojnë se situata politike jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon nuk është e qëndrueshme. Lutfi Haziri, nënkryetari i partisë më të madhe opozitare në Kuvendin e Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës, thotë se rajoni në përgjithësi nuk mbahet mend të ketë qenë më i trazuar sesa që është në këtë vit. "Tirana po vlon nga një sindromë e re që e ka prekur opozitën atje, protestat dhe pakënaqësitë sociale. Beogradi po ashtu, opozita po provon që pakënaqësitë t'i zgjidhë në rrugë përmes protestave. Kemi një heshtje nga opozitat në Maqedoni karshi suksesit të kryeministrit Zoran Zaev në arritjen e marrëveshjes me Greqinë. Por, edhe atje situata është në ekzaltim të këtij suksesi... Por, pakënaqësitë janë gjithandaj, pa përmendur Bosnjë e Hercegovinën dhe gjendjen që kemi në Prishtinë", thotë Haziri. Ai thekson se partnerët ndërkombëtarë të Kosovës, qofshin ata në Bashkimin Evropian, në NATO apo në Uashington, po e shohin këtë situatë të brishtë si të rrezikshme, për shkak të rritjes së pakënaqësisë sociale. "Do të jetë e pafalshme nëse Kosovës i përsëritet ndonjë ngjarje e dhunshme. Do të jetë e pafalshme nëse i përsëritet Shqipërisë viti '97, ose e pafalshme edhe për Serbinë, sepse edhe ata kanë kaluar në procese të rënda, edhe Bosnjës e Hercegovinës. Krejt ky ambient kërkon përkrahje të madhe politike dhe unitet. Nuk ka rrugë tjetër për të kaluar", thekson Haziri. Edhe analistët politikë tërheqin vërejtjen për rrezikun që mund të vijë si pasojë e rritjes së pakënaqësisë sociale në vendet e rajonit, përfshirë edhe Kosovën. Sipas tyre, gjendje të tilla janë rezultat i keqkeqverisjes. Analisti



Artan Muhaxhiri, duke folur për Radion Evropa e Lirë, pos tjerash thotë se nga përparimi i dialogut Kosovë-Serbi, varen edhe shumë zhvillime, jo vetëm për Kosovën, por edhe për rajonin në përgjithësi. Ai thotë se gjendja e status quo-së është e dëmshme për të dyja palët, Kosovën dhe Serbinë. Ndërkaq, deklaratën e presidentit Thaçi për mundësinë e destabilizimit të rajonit në rast të mungesës së një marrëveshjeje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Muhaxhiri e sheh edhe si një lloj kërcënimi diplomatik. "Raportet mes Kosovës dhe Serbisë janë jashtëzakonisht

komplekse dhe kanë ndikim të madh në Ballkan, pra si në aspektin pozitiv, ashtu edhe negativ. Prandaj, edhe pesha politike është shumë e madhe. Ka mundësi që nëse nuk arrihet një marrëveshje finale, atëherë forcat të cilave u intereson destabilizimi, që në radhë të parë dirigjohen nga Rusia, ta shfrytëzojnë vakumin dhe të ndikojnë negativisht në proceset politike dhe sociale", vlerëson Muhaxhiri. Ai thotë po ashtu, se derisa shihet një angazhim i faktorit ndërkombëtar, në radhë të parë i SHBA-ve dhe BE-së për një zgjidhje të problemit mes Kosovës dhe Ser-

Presidenti Hashim Thaçi gjatë kësaj jave tha se në 12 muajt e fundit, në raportet mes Kosovës dhe Serbisë ka vetëm regres. "Nuk kam kurrfarë dyshimi që nëse këtë vit nuk do të bëjmë marrëveshje ligjërishit detyruese mes të Kosovës dhe Serbisë, do të hyjmë në një zonë të rrezikshme të këtyre raporteve, që mund ta destabilizojnë gjithë rajonin", deklaroi Thaçi.

bisë, Rusia sipas tij, më tepër do të preferonte një gjendje kaosi në Ballkan. "Nuk mund të anashkalohen edhe trazirat, edhe keqpërdorimi dhe instrumentalizimi i situatës së amullisë", shton ai. Arritja e marrëveshjes paqësore ndërmjet Kosovës dhe Serbisë po provohet përmes procesit të negociatave, i cili sipas paralajmërimeve në Prishtinë dhe Beograd, po hyn në fazën finale. Aktualisht, mospajtimet qëndrojnë në faktin se a duhet apo jo që pjesë e negociatave të jetë edhe opsioni i ndryshimit të kufirit, për çka ka dallime si brenda spektrit politik në Prishtinë, ashtu edhe tek ai në Beograd. Instituti Kërkimor

për Çështje Evropiane dhe të Zhvillimit (RIDEA) gjatë javës që po lëmë pas prezantoi një sondazh, që u jep përgjigje disa prej dilemave kryesore që e karakterizojnë dialogun e fazës finale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Nga gjetjet e prezantuara mes tjerash është thënë se 62 për qind e qytetarëve mbështesin vazhdimin e dialogut në formatin aktual. Shkëmbimin e territoreve mes Kosovës dhe Serbisë, në këmbim të njohjes dhe anëtarësimit të Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB) e kanë mbështetur vetëm 30 për qind e qytetarëve të Kosovës.

Arritja e marrëveshjes paqësore ndërmjet Kosovës dhe Serbisë po provohet përmes procesit të negociatave, i cili sipas paralajmërimeve në Prishtinë dhe Beograd, po hyn në fazën finale. Aktualisht, mospajtimet qëndrojnë në faktin se a duhet apo jo që pjesë e negociatave të jetë edhe opsioni i ndryshimit të kufirit, për çka ka dallime si brenda spektrit politik në Prishtinë, ashtu edhe tek ai në Beograd.

Intervista e Ditës

# Po troket përsëri '97-a?

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

... për 30 ditë gati luftë civile, po na troket sërish në derë, nga largësia e 21 viteve ku është gremisur. Qytetarët e tjerë presin me shqetësim të shtuar si do të silltet opozita e porsa vetëflakur nga parlamenti. A ka ndonjë plan të qartë përpara vetes, përtej disa deklaratave emocionale të drejtuesve të saj, që vetëm shtojnë pëshqjellimin te njerëzit? A po mendon vërtet protesta të reja të dhunshme për të arritur qëllimet e saj të deklaruara (largimin e kryeministrit të sotëm nga pushteti dhe zgjedhje të parakohshme)? A ka ndonjë synim tjetër, përveç atyre që ka deklaruar? Pra, një plan "B"? A do të vijin ndërkombëtarët të provojnë të bisedojnë me palët ndërluftuese, sikurse bënë në shkurt-mars 2017, sidomos me opozitën, që në atë kohë nuk pranonte e nuk pranonte të hynte në zgjedhje? Përmes gjithë kësaj gjendjeje të pazakontë e të turbullt në maksimum, qeveria duket se po bën të vetmen gjë që nuk duhet të bëjë. Të provokojë kundërshtarin politik. Të kujtojë prag '97-ën. Realisht qeveria duhet t'ia fusë një shuplakë të fortë vetes dhe të përmendet. Nuk është më në situatën e këtyre pesë viteve e gjysmë, kur parlamenti, edhe pse jo rrallëherë i braktisur për kohësisht nga opozita, funksiononte. Qeveria duhet të kuptojë, të dijë se në ç'tokë po qëndron tani. Parlamenti realisht sot nuk është më i tillë. Kjo s'ka të bëjë fare me zgjidhje teknike. Ai ka pushuar së qeni. Duhet rikthyer në gjendjen e mëparshme me çdo çmim. Prandaj ia vlen për qeverinë, për llogari të të gjithë neve (por edhe të sajën), të silltet në mënyrë të kundërt dhe të mos sulmojë. Sulmet sot peshojnë njëqindfish. Qeveria duhet të japë shenja pajtimi, afrimi. Të rihapë lojën e reformës zgjedhore, edhe pse tani nuk ka kohë materiale për të bërë ndonjë gjë për të. Të ofrojë edhe gjithçka tjetër, nëse mundet. Duhet t'i largohet qasjes se vetëm po shava, sulmova dhe anatemovala kundërshtarin politik, jam e fortë. Të bëjë të fortën do të ishte veprimi më absurd dhe më dëmsjellës. Ka përënduar kjo kohë muskujsh. Në situatë të tilla fiton politika e çtensionimit dhe e afrimit. Gjermanët bashkuan dy shtete gjermane të ndara nga ideologjia me "real-politik" (politikën reale) të kancelarit Helmut Kohl. Ne nuk jemi një shtet i ndarë. Kemi 106 vjet të bashkuar. Qeveria duhet të provojë të shpikë një 17 prill 2017 të dytë, ndoshta shumë më të zbehtë, por të jetë një ofertë reale për të ulur në tryezën e bisedimit opozitën. Nuk ka rëndësi sa kokëfortë, sa rezistente apo refuzuese do të tregohet opozita. Por ndërkohë i ke larguar asaj nga koka aktet e dhunës, duke e shtyrë dorën e pajtimit. I ke shuar për kohësisht ata motorë të rrezikshëm të urretjes dhe shkatërrimit, që duket se disa brenda opozitës duan të ndezin. Kjo nuk është një



fitore e paktë, po ta arrish. Dhe arrihet duke mos menduar më pikët zgjedhore me hartimet kundër kundërshtarit politik. Kaq e vështirë është kjo qasje për qeverinë tonë të sotme? Ajo ka përgjegjësinë kryesore për të mos e lënë situatën të përshkallëzohet

në tensionin dhe paqartësinë e vet. Prej nga realisht mund të lindin akte dhune të pakontrolluara. Dhe nuk është më në lojë imazhi i vendit, i tronditur fort nga dhuna e 16 shkurtit në hyrje të Kryeministrit. Në lojë kësaj radhe është qetësia e mirëfilltë e vendit, e të

gjitha familjeve shqiptare. Kush do të luajë sot me këtë qetësi, do të marrë damkën e zjarrvënësive të Shqipërisë. Qeveria duhet të provojë me të gjitha mënyrat të shuaja urtë e zjarrit, që edhe mund të ndizen pikërisht tani kërcënueshëm, pse ndizen pa zhurme dhe vëmendje. Populli thotë "qeni që lehn nuk të ha". Qeveria, por edhe të gjithë ne si shqiptarë duhet t'u ruhemi pikërisht atyre që si pa u kuptuar do të provojnë të bëjnë dëm, akte vandalizmi apo të dëmtojnë në një mënyrë ose në tjetrën punën e institucioneve. Do të ketë të tillë? Urojmë të mos ketë, por nëse vazhdon kjo klimë e turbullt dhe tejet e tensionuar, këto sulme nga të dyja anët (sidomos të pafalshme janë ato nga ana e njerëzve të qeverisë), diku mund të shpërthejë ajo që i ndruhem i gjithë. Dhe fantazmat e '97-ës fatalisht mund të mos duken më aq larg. Do Zoti për të gjithë ne të mos jetë kështu!

A ka ndonjë plan të qartë përpara vetes, përtej disa deklaratave emocionale të drejtuesve të saj, që vetëm shtojnë pëshqjellimin te njerëzit? A po mendon vërtet protesta të reja të dhunshme për të arritur qëllimet e saj të deklaruara (largimin e kryeministrit të sotëm nga pushteti dhe zgjedhje të parakohshme)? A ka ndonjë synim tjetër, përveç atyre që ka deklaruar? Pra, një plan "B"?

## HOROSKOPI

### DASHI

Çështjet e parave po bëhen gjithnjë e më shumë shqetësuese për të lindurit në këtë shenjë. Megjithatë, tregoni më shumë kujdes me disa informacione që mund të bëjnë ndryshime të mëdha në jetën tuaj. Me çështjet e dashurisë duhet më tepër angazhim.

### DEMI

Sapo të zgjoheni këtë mëngjes, mund të zbuloni një ndryshim që e prisni prej kohësh. Brenda natës, pengesat që menduat se i kishit në rrugën tuaj, sot largohen si me magji.

### BINJAKET

Sot mund të keni një partneritet që do të rritet në një situatë shumë të dobishme. Keni disa njerëz shumë të veçantë në jetën tuaj, të cilët do të tregojnë mbështetje për ju. Me paratë, gjërat duken normale.

### GAFORJA

Mëshohuni ta vlerësoni atë që keni dhe të mos dëshironi gjëra që mund të mos i keni kurrë. Sot do të jetë një nga ato ditë, ku nëse nuk tregoheni i vëmendshëm mund t'ju rrëshqasë nga duart diçka e rëndësishme.

### LUANI

Nëse disa mënyra të vjetra nuk kanë funksionuar, ka ardhur momenti që të ndryshoni strategji. Mos humbni asnjë moment, por hidhuni në sulm. Veproni pa frikë. Rezultatet do të jenë aq fenomenale, saqë nuk do të ktheheni kurrë në mënyrën tuaj të menduarit.

### VIRGJERESHA

Problemet e thjeshta dhe pa kuptim ju mbajnë aktiv gjatë gjithë ditës. Jeni në një nevojë për të bërë gjithçka që të funksionojë në mënyrën e duhur. Kush-tojni më shumë vëmendje aspektit romantik.

### PESHORJA

Ka një energji të fokusuar brenda jush dhe po rritet çdo ditë e më shumë, e nxitur nga admirimi që të tjerët tregojnë ndaj jush. Vetëbesimi juaj është duke shpërthyer, por mbajeni atë nën kontroll deri në kohën e duhur.

### AKREPI

Egziston diçka që ju dëshironi t'ia thoni dikujt dhe është e lidhur me një temë shumë delikate. Për fat të mirë, dita e sotme do t'ju ofrojë një mundësi të mrekullueshme për të shprehur atë që keni në mendje.

### SHIGJETARI

Tregoni më shumë seriozitet ndaj njerëzve që ju rrethojnë. Nëse ata kanë një kërkesë ndaj jush, ndoshta ka ardhur momenti që ta mendoni me kujdes. Sa u përket parave, jini më i vëmendshëm ndaj shpenzimeve.

### BRICJAPI

A keni vështirësi sa u përket parave? Nuk mund të qëndroni duarkryt dhe të ndjeheni 100 për qind të sigurt mbi gjendjen tuaj financiare. Njëkohësisht kështilloheni që të ruani më shumë dhe shpenzoni më pak.

### UJORI

Negociatat po bëhen më të rëndësishme në jetën tuaj dhe fleksibiliteti do të ndihmojë të merrni atë që dëshironi. Është koha që të vendosni prioritet tuaj në rregull dhe të kuptoni se çfarë jeni të gatshëm të jepni për hir të asaj që dëshironi.

### PESHQIT

Ju duhet të ruani një ritëm normal tani dhe t'i jepni vetes më shumë kohë për t'i trajtuar gjërat me kujdes, veçanërisht në aspektin financiar. Të qenit i nxituar ju çon në rrugë gabuar. Me shëndetin tregohuni më i vëmendshëm.

Superliga/ Kastrioti ndal Laçin

Kukësi mposht Kamzën dhe shkon në -8 nga Partizani

Kukësi i dha fund kësaj serie negative, duke u kthyer te fitorja në Superligë dhe në ndjekje të Partizanit, në garën për titullin kampion. Pas dy humbjeve radhazi, skuadra e drejtuar nga Armando Cungu mundi 3-2 Kamzën për të ruajtur sërish diferencën prej tetë pikësh me kryesuesit. Gjithsesi, deri te suksesi në ndeshjen e javës

së 23-të, verilindorët vuanjtën jo pak, pavarësisht epërsisë së shpejtë me golin e Vasil Shkurtajt që në minutën e tetë. Por të besuarit e Armando Cungut nuk arritën të ruanin avantazhin. Në të 41'-ën, Fukui ndali topin në rrjetë për të kthyer skuadrat në ekuilibër në dhomat e zhveshjes. Me rikthimin në fushë pas pushimit, Valdet Rama shënoi golin e dytë për Kukësin në minutën e

46-të. Në të 60'-ën, Rroca thelloi në 3-1 avantazhin e vendësve, duke dhënë përshtypjen e një sfide të mbyllur para kohe. Por, të besuarit e Cungut ia vështirësuan punën vetes, pasi në minutën e 77-të, i hedhur në fushë si zëvendësues,

në topin e parë të prekur Martinena ngushtoi diferencën me një gol shumë të bukur. Në sfidën tjetër të së dielës në Superligë, Laçi nuk shkoi më shumë se barazimi 1-1 në fushën e Kastriotit. Skuadra kurbinase shënoi shpejt golin e

epërsisë me Fangajn në minutën e dhjetë, ndërsa arriti të ruajë këtë avantazh minimal deri në fundin e pjesës së parë. Por, me rikthimin në fushë për pjesën e dytë, Shehu në minutën e 53-të barazoi rezultatin dhe vulosi fatin e sfidës.

SUPERLIGA	
<b>TE PREMTEN</b>	
Skënderbeu - Tirana	1-2
<b>TE SHITUNEN</b>	
Luftëtari - Teuta	1-0
Partizani - Flamurtari	3-1
<b>TE DIELEN</b>	
Kastrioti - Laçi	1-1
Kukësi - Kamza	3-2
<b>RENDITJA</b>	
Skuadra	P
Partizani	49
Kukësi	41
Teuta	39
Laçi	35
Skënderbeu	33
Flamurtari	33
Tirana	28
Luftëtari	25
Kastrioti	20
Kamza	16

Federata kërkon bashkëpunim e policisë për gjetjen dhe ndëshkimin e shoktarëve të sulmit



Jeton Selimi

# FSHF: Të ndëshkohen dhunuesit, Partizani distancohet nga incidenti

Të kuqtë në kundërsulm: Fotografi, jashtë protokollit

Ndonëse kishte ende dy ndeshje për t'u zhvilluar, fatkeqësisht kryefjala nuk ka qenë futboli, por incidenti i djeshëm në kryeqytet. Federata Shqiptare e Futbollit dënon me ashpërsi dhunën e ushtruar ndaj fotografit të klubit "Flamurtari" gjatë ndeshjes Partizani-Flamurtari, të zhvilluar ditën e djeshme në stadiumin "Selman Stiermasi". FSHF-ja tregohet e ashpër me individët shoktarë të dhunës dhe kërkon bashkëpunimin e policisë, ndërsa duket se do të ruajë të njëjtin linjë si në rastin e Kukësit, Tiranës, Flamurtarit apo Skënderbeut. "Ata e cilësojnë se një ngjarje e tillë nuk ka aspak lidhje me lojën e futbollit dhe frymën 'fair play' që duhet të përcjellin të gjithë dhe u bëjnë thirrje klubeve që të punojnë sa më shumë me tifozëritë dhe stafet e tyre që ngjarje të tilla të mos përsëriten më. Në të njëjtën kohë u bëjmë thirrje organeve ligjzbatuese, Policisë së Shtetit dhe prokurorisë që të vendosin përpara ligjit agresorët, të cilët janë evidentuar nga pamjet filmike. FSHF-ja dhe zyrtari i klubit 'Flamurtari' kanë dorëzuar kallëzimin penal, tani është koha që policia të veprtojë. Situata dhe ngjarje të tilla nuk duhet të përsëriten më në stadiumet



shqiptare. FSHF-ja do të qëndrojë në kontakt të vazhdueshme me autoritetet përkatëse të rendit dhe me klubet për t'i dhënë një zgjidhje përfundimtare këtij problemi, që

dëmon dhe cenon imazhin e futbollit shqiptar".

**REGIMI I PARTIZANIT**

Pas dhunës në ndeshjen Partizani-Flamurtari, ku disa tifozë goditën fotografin e klubit vlonjat, ka reaguar për herë të parë zyrtarisht klubi i kuq i kryeqytetit. Në një njoftim për mediat, të shpërndarë në rrjetet sociale, Partizani dënon ashpër dhunën, por distancohet autorët nga grupimet zyrtare të skuadrës. Po ashtu, kryesuesit e Superligës hidhen në kundërsulm, duke bërë të ditur se fotografi i dhunuar nuk ishte pjesë e klubit 'Flamurtari', pasi emri i tij nuk figuronte në protokollin e ndeshjes. "FK 'Partizani' distancohet nga incidenti i ndodhur ditën e djeshme gjatë takimit Partizani-Flamurtari, i cili absolutisht nuk mund të jetë pjesë e lojës së futbollit dhe 'fair play'. Politika e qartë dhe e vendosur e klubit përçatë gjithë këtij sezoni është

dhe mbetet që 90 minutat e lojës të dhurojnë një atmosferë të vërtetë sportive, për ta bërë futbollin pjesë të jetës së familjeve shqiptare, sa më larg dhunës dhe provokimeve. Kemi ndjekur me vëmendje pasqyrimet në media dhe reagimet në lidhje me këtë incident, ku përgëzojmë grupimet tona zyrtare për qëndrimin e mbajtur në dënimin e çdo akti, që nuk është pjesë e spektaklit të bukur të futbollit. Dëshirojmë të saktësojmë se autorët të këtij incidenti ishin disa individë, të cilët kurrsesi nuk mund të përgjithësojnë tifozërinë e madhe të Partizanit, e cila u distancohet menjëherë dhe në stadium nga këta individë, që nuk dimë se interesat e cilës palë përfaqësojnë. Gjithsesi nëpërmjet pamjeve filmike të pasqyruara shihet qartë se 'personi me aparat fotografik' ka luajtur një rol aktiv duke provokuar individët që ju afruan, në mungesë totale të forcave të sigurisë, të cilët

janë përgjegjësit e vetëm për mbarëvajtjen e garës dhe moslejimin e këtyre provokimeve dhe incidenteve. Në media është pasqyruar se është goditur një zyrtar i klubit të 'Flamurtarit', ndërkohë që emri i këtij personi nuk figuron në listën e fotoreportërëve të akredituar për këtë takim. Ndaj, mbetemi ende të paqartë se çfarë funksioni ka në klubin 'Flamurtari' personi, i cili u përfshi në këtë incident. Nga ana jonë saktësojmë se ne si klub kemi një bashkëpunim të vazhdueshëm me tifozëritë tonë, e cila shquhet për mbështetjen ekzemplare që i jep skuadrës së në shpëll, ashtu edhe jashtë saj. Klubi i 'Partizanit' është distancohet historikisht dhe ka dënuar çdo lloj dhune të shfaqur në stadiumet tona, pavarësisht se kundodhin, në Tiranë, Korçë, Kukës, Laç, apo gjetiu. Ne jemi dhe do vazhdojmë të mbetemi partizanë të vërtetë të 'fair play'-it për një futboll të bukur e gjithëpërfshirës".

PËRCAKTOHET AXHENDA

Ndeshjet e javës së 24 të Kategorisë Superiore do të nisnin me atë që cilësohet si përballja më interesante, derbi i kryeqytetit, ku Tirana pret Partizanin në "Selman Stiermasi". Një sfidë e ndezur për të cilën FSHF-ja ka menduar orarin e veçantë të së premtes në darkë, për t'u dhënë mundësinë të gjithë tifozëve të shijojnë emocionet e kësaj sfide. Kjo është padyshim kryendeshja e javës, por që njëkohësisht do t'u japë mundësinë rivalëve të Partizanit kryesues që një ditë më vonë të men-

Java e 24-ët nis me derbin e madh të kryeqytetit

dojnë si të rikuperojnë pikë ndaj të kuqeve apo të frenojnë arratinë e tyre. Kukësi luan të shtunën sfidën e vet me Luftëtarin në orën 14:00, në një stadium për t'u caktuar ende. Ndërsa pasdite, në orën 17:00, në fushë zbrit Teuta, e cila pret Skënderbeun që po mundohet të evitofjë humbjen e 9 në 10 ndeshjet e fundit. Java mbyllet me duela shumë interesante, duke filluar nga Kamza-Laçi në orën 14:00, që është përcaktues për luftën

SUPERLIGA	
JAVA E 24-ët	
<b>TE PREMTEN</b>	
Tirana-Partizani	18:00
<b>TE SHITUNEN</b>	
Kukësi-Luftëtari	14:00
Teuta-Skënderbeu	17:00
<b>TE DIELEN</b>	
Kamza-Laçi	14:00
Flamurtari-Kastrioti	17:00

e mbijetesës. Ndërsa, ai që i vë vulën javës së 24-të është dueli në Vlorë mes Flamurtarit dhe Kastriotit.

SULMUESI ARGJENTINAS

Jashtë fushe që nga 14 shkurti për shkak të një problemi në gju, që shoqëroi vendimin e Interit për t'i hequr shiritin e kapitenit, Mauro Icardi mund të ketë luajtur ndeshjen e tij të fundit me skuadrën zikaltër. Lajmi shokues vjen nga media italiane. Siç raporton "Corriere Dello Sport", sulmuesi argjentinas ka vendosur t'u japë fund njëherë e përgjithmonë shqetësimeve në gju dhe duke përfutur nga situata që është krijuar, do t'i nënshtrohet ndërhyrjes kirurgjikale. Kjo do të thotë se sezoni i Mauro Icardit do të mbyllet përpara kohe. Jo vetëm kaq,


Icardi, operacion dhe lamtumirë! Në verë ikën nga Interi



pasi me operacionin do të përfundojë edhe karriera e tij me Interin. Pas vendimit të klubit, raporti me sulmuesin është prishur dhe në merkaton e verës ai do të shqyrtojë të

gjitha ofertat, të cilat kanë nisur të vijnë që tani. Juventusi dhe Reali i Madridit janë krye të listës, ndërsa Icardit i duhet vetëm të zgjedhë se ku do të vazhdojë karrierën.

**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

2. Gjëja e latinëve.
5. Ai i Kuq u hap për hebrejtë.
9. Eshhtë fjala e për e foshnjës.
11. Ministri Ekonomisë e Pune
13. Marubi i fotografisë.
14. Bel i Mappussant.
15. Bëhet duke tregtuar objekte të shenjtja.
18. Derek aktore.
19. Gjysmë totale.
20. Eshhtë art i të folurit
22. Një patriark biblik.
24. Mund të jenë zemërkau të tilla.
26. Janë dëshmorë të kishës.
28. Eshhtë lloj papagalli.
29. Eshhtë lloj papagalli.
30. Qerre pa qe.
32. Ekstremit në numërim.
33. Eshhtë bodrumi.

34. Steiger aktor.
35. Inicialet e Delon.
37. Eshhtë edhe ai Me Gropa.
38. Një mund të jetë autonom.
40. Në krye të evidencës.
42. Edgar Allan Poe.
44. Ekstremit në litar.
46. Giorgio i modës.
50. Janë malet me Akonkagua.
52. Janë ujërat e bregdetit tonë.

**VERTIKAL**

1. Novarro që qe aktor.
3. Kusturica regjisor.
4. Eshhtë e jashtëzakonshme.
6. Inicialet e Kazan.
7. Ishte qyteti i 100 portave.
8. Pinci i Dy herë mat.
9. Janë të mirat që prodhohen.
10. Eshhtë ai që gënjën për t'u bërë i njo-
- hur.
11. Një markë celulari.
12. Ushtrohej nga filibustierët.
16. Një përsiatje.
17. Agjenci Informativë Tiranë.
21. Një brejtës pylli.
23. Një Gjon që qe aktor i yni.
25. Titulli i Byron.
27. Në radhë të parë.
31. Emri i Amundsen.
36. Moore aktore.
39. Pishtarë pa pishë.
41. Gjysmë vatani.
43. Rruga e Molnar.
45. Një fazë gjumi.
47. Inicialet e Redford.
48. Në krye të notarëve.
49. Inicialet e Reitman.
51. Unë dhe ti.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


1. Nuk kalohet nga mbetësi.
5. U printe gladiatorëve
12. Bëhet duke shkuar lart e më lart
14. Tatum që qe pianist.
15. Një që lufton për para
16. Mund të bëhet me safari
17. Breshkat luftarake të kartonave
19. Ngjitet kur nuk nget
20. Në mes të rrugës
21. Sporti me rikisha
25. U shkrua nga Hesiodi
26. Një sferë për model
27. Mbyllin një sirtar
28. Makina Tipo
30. Inicialet e Bean, aktor
31. Nino, kompozitor i famshëm italian
33. Ramiro pa zë.
34. Neill i Jurassic park.

**VERTIKAL**


35. E bukura e belle epoque.
37. Qe mbreti i elfëve
39. Farrow, aktore
40. Hagen rocskart
41. Walter i Kush do ta vrasë Charley Verrik
45. Në fund majtas
46. Mund të preken nga morbusi i Basedow
47. Ad... për të ngarkuarin me punë
48. Loach regjisor
9. Qytet zviceran
10. Në krye të kryesisë
11. Ughi violinist
13. Carlos që qe pilot i Formula 1
15. Ekstremit në muzg
18. Inicialet e Steinbeck
22. Gruda, "Njeriu me top"
23. Eshhtë X ajo e sulmit
24. Paradhoma e parajasës
28. Eshhtë edhe ai i luftës
29. Janë edhe ato të cirkut
31. Mbarojnë fare
32. Inicialet e Reed, aktor
34. Të parët në sondazh
36. Eshhtë taksa
38. Një mund të jetë emërоре
39. Një pjesë e marrëzisë
41. Gjysmë mimoze
42. Hundë kur s'jam unë
43. Skuadër greke
44. Lempër, këngëtare gjermane
46. Fundi i një akti



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

A	R	T	E	T	K	A	M	P	U	L	A
R	E	A	L	T	A	H	A	R	R	I	S
O	R	K	P	E	R	S	N	K	N	P	
M	T	H	E	R	R	I	M	E	T	D	I
A	K	E	S	M	E	R	E	T	K	O	R
T	U	R	H	A	M	E	S	R	E	R	A
S	E	C	I	L	I	N	M	O	T	E	T
M	A	D	A	M	E	A	K	O	M	E	A
I	R	O	N	I	A	T	O	M	E	T	A
T	I	N	A	B	E	L	L	O	I		
E	A	H	A	L	I	L	I	S	A	M	
T	D	I	A	N	A	A	N	T	E	N	A
P	A	R	I	C	A	P	A	L	L	A	T
R	U	U	D	E	R	A	H	E	R	E	T
O	T	L	P	R	R	P	T	I	M	O	
V	O	L	A	M	A	T	O	R	T	P	N
O	R	A	S	A	T	I	R	E	T		
K	E	V	A	S	H	A	T	B	E	L	A
A	T	A	R	I	S	E	K	A	R	R	A
O	R	T	A	K	E	T	B	E	M	E	R
R	O	Q	E	V	E	R	I	A	N	O	T
E	M	U	T	E	M	E	Z	E	R	O	T
T	A	P	A	N	E	L	L	Y	T	I	M

**FJALËKRYQI (1)**

**FJALËKRYQI (2)**

**SUDOK**

	9	7			2	4		
				9			2	8
4		5	6	7			1	
					7			
	3							
		6		5	9			
			1					4
7	6	4						
1	8				3	6		

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

3	7	8	2	5	9	4	6	1
1	6	9	3	4	7	5	8	2
2	4	5	6	8	1	7	3	9
4	1	2	5	7	3	6	9	8
5	8	3	9	6	4	1	2	7
6	9	7	1	2	8	3	4	5
7	2	1	4	9	6	8	5	3
8	5	4	7	3	2	9	1	6
9	3	6	8	1	5	2	7	4

*Argëtim filozofik*

- Dëmbelizmi ecën aq ngadalë sa që varfëria e arrin menjëherë.
- Nëse prindërit punojnë dhe fëmijët e tyre i'a kalojnë mirë, atëherë nipërit e tyre sigurisht do të përfundojnë lypsarë.
- Balta e vetme që na bën pis, është ajo që ua hedhim të tjerëve.
- Nëse pajtohem me ty, do të ishim të dy gabim.
- Nëse më interesonte se çfarë thonë pas shpinës time, nuk do ta kisha kthyer.
- Për të thënë të vërtetën, ka nevojë për dy: një për ta thënë, dhe një tjetër për ta dëgjuar.

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm

17	1	8	4	2	4	13	1	13	1	E	L	E	K	T	R	I	K	K	U	R	A
18	3	1	4		18	3		17	13	T	E	R	R	E	N	I	K	A	N	A	L
8	1	10	10	10	1	3	1	6	12	I	R	M	A		F	O	N	I	K	E	
3		1	10	2	5	6	14	1	12	K	A	V	I	K	T	I	M	A	T	K	
	13	3	5	4	2	8	4	1	12	A	M	A	R	R	E	Z	I	T	E	S	
15	9	6	15	1	12	4	6		6	M	E	T	E	O	R	I	T	E	T	A	
17	2	4	5	12		2	14		17	R	O	M	A	N	T	I	K	E	T	Z	N
	8	1	7	6		3	1	10	1	E	N	E	D	A	T	T	K	O	D		
15	5	12			4	6	4	18	7	C	I	C	E	L	A	I	K	O	N	E	
1	A	3	2	8		1	5			E	T	E	R	O	L	A	Z	A	R		
20	19		1	3		20	5	4	6	T	O	E	A	F	A	T	A	L			
6	1		10	2	3	2	12	15	18	A	R	K	I	V	A	T	D	A	K	E	T

*Thënie të mençura*

- Disa, ndërsa dominojnë qytetet dhe popujt, bëhen skllëvër para grave.
- Në jetë ekzistojnë: dashuria, urrejtja, mospërfillja. Jep çfarë të duash, merr çfarë jep.
- Hapi i parë drejt njohurisë është të kuptojë dikush injorancën e tij. Por për të vlerësuar madhësinë e saj, duhet të studiojë shumë dhe mirë.
- Që të jeni në kujtimet e fëmijëve tuaj nesër, DUHET të jeni në jetën e tyre sot!

